

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 8 Korrik 2013

ISSN 2225-2959



9 772225 295004



RREGULLIMI BANKAR

A po arrin pikën kritike?



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



*KARTAT BANKARE ...
Për kënaqësitë që të rezervon jeta!*

Broshura mbi kartat bankare dhe përdorimin e tyre është pjesë e angazhimit të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Bankës së Shqipërisë në fushatën e edukimit financiar. Për më tepër informacion: www.aab.al

ANËTARËT E AAB

Përmbajtja

EDITORIAL

Rregullim bankar tredimensional!
nga Elvin MEKA

f.5

TEMA E DITËS

Rebusi i rregullimit financiar
nga Viktorija PROSKUROVSKA

f.6

Rregullimi bankar – një e ardhme bankare komplekse
nga Avis ANDONI

f.9

Investimet e bankave jashtë Shqipërisë - Një përpjekje e kushtueshme nga Besart KADIA

f.11

INTERVISTA

Viti 2012 - një vit i suksesshëm për Fibank Albania
Intervistë me Bozhidar TODOROV

f.13

SISTEMI BANKAR

Ekzekutimi i kolateralit një tipar i rëndësishëm
i tregjeve financiare të suksesshme
nga Periklis DROUGKAS

f.14

Kolaterali financiar, një risi në të drejtën shqiptare dhe
sfidat e zbatimit të tij nga Holta ZAÇAJ

f.15

Kultura e rrezikut si ndihmesë në drejtimin efektiv të
rrezikut në banka nga Artiola AGALLIU

f.18

FORUMI I EKSPERTËVE

Partneritetet Publik-Privat (PPP) dhe Raportimi Financiar
nga Hysen ÇELA dhe Kledi KODRA

f.21

Konsiderata teorike dhe aspekte të mbikëqyrjes së
sistemit të pensioneve - Mundësitë në Shqipëri
nga Enkeleda SHEHI

f.23

Mjetet e analizës për vlerësimin e rrezikut - Matrica e
klasifikimit të rrezikut fizik nga Roland TASHI

f.26

KËNDI I EKONOMISTIT

Marrëveshja europiane për strukturimin apo
likuidimin e bankave në krizë nga Adrian CIVICI

f.29

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Aktivitete nga Bankat

f.31

NJË BANKIER NDRYSHE

f.33

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.34

TEKNOLOGJI

E-COMMERCE – një realitet tashmë i prekshëm në
Shqipëri nga Marsela KUSHTA

f.37

AUDITORI FINANCIAR

Përdorimi i instrumenteve të pagesave nga individët dhe
bizneset nga Kliti CECA, Valentina SEMI, Alban PLLAHA

f.39

AAB

Aktivitetet e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.42



BANKIERI është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. BANKIERI i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arrijtjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

Bankieri

Nr. 8, korrik 2013

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshi)

Bashkëpunëtorë

Anduena Manushi

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Design & Layout: Ladybird Creations

Shtypi:  Gent-grafik

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUÇIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm,
NBG Bank Albania

Alexander RESCH

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,
Intesa Sanpaolo Bank Albania

Hubert de SAINT JEAN

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,
Societe Generale Albania

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm
Fibank Albania

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm
Alpha Bank Albania

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale
Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

Aksesori më i rëndësishëm që duhet të keni në çdo moment këtë verë është karta juaj e kreditit Alpha Bank. Kryeni **15 blerje** gjatë muajve Qershor, Korrik, Gusht dhe përfitoni **15% rimbursim** mbi të gjitha blerjet e kryera në muajin Shtator.

Aplikoni sot për një kartë krediti Alpha Bank dhe përfitojeni atë me komision vjetor **ZERO!**

Festojmë së bashku 15 vjet në Shqipëri!

Blini në Verë!



Përfitoni në Vjeshtë!

*Alpha Bank është lëshuese ekskluzive e kartave American Express® në Shqipëri

** Shuma minimale e blerjeve të kryera duhet të jetë 1,500 Lek.

*** Shuma maksimale e rimbursimit është 15,000 Lek.



ALPHA BANK

15vjet
NË SHQIPËRI

RREGULLIM BANKAR TREDIMENSIONAL!



nga Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Rregullimi i veprimtarisë bankare është domosdoshmëri, por gjithsesi duhet të kihet parasysh se, rregullat e suksesshme janë të rralla, kurse sukseset e tregut janë të shumta.

Rregullat dhe rregullimi janë një fakt i jetës së përditshme, e si të tilla nuk mund të shpëtojmë dot prej tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për sektorin bankar, që mund të thuhet se tashmë nuk është i mirërregulluar, por tejet i rregulluar. Zakonisht, rregullimi fillon e bëhet shprehje e ditës gjatë një krize financiare ose ekonomike, apo pas shpërthimit të saj, e në kushte të tilla ai gjykohet si “vaksina” më e mirë ndaj kolapsit të të gjithë sistemit financiar, si dhe frenuesi më i mirë i ortekut të rreziqeve që shkakton, në këto raste, “instinkti i turmës”. Rrënimi spektakolar që shkaktoi kriza e vitit 2008, ishte një rast “par excellence” i shpërthimit të një oreksi rregullator në rrafsh global, por me objektiv të qartë drejt industrisë bankare. Nga një këndvështrim i gjerë, një qasje e tillë duket e përshtatshme dhe e mirëpritur, pasi duhet pohuar se sektori financiar dhe industria bankare ishte vatra e krizës. Kështu, për tre vite radhazi u bëmë dëshmitarë të një sipërmarrjeje rregullatore sistematike, si në rrafshin global, ashtu dhe në atë europian, që synonte rregullimin e çdo metri katror të aktivitetit bankar.

Konkretisht, “vrapi” filloi me diskutimet dhe kërkesat e Bazel III, për të vijuar me mjaft nisma rregullatore dhe institucionale europiane, që u formësuan në krijimin e tre autoriteteve mbikëqyrëse europiane, si: Autoriteti Bankar European (EBA), Autoriteti European i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) dhe Autoriteti European i Tregjeve dhe Titujve (ESMA), Bashkimi Bankar European, miratimi i “arkitekturës” rregullatore europiane të bankingut - Direktiva IV e kërkesave të kapitalit/Rregullorja e kërkesave për kapital (CRR) - e së fundi, rregullat për shpëtimin e bankave europiane, që synojnë t’ia kalojnë humbjet

kreditorëve e për rrjedhojë ta ndihmojnë Europën të lëvizë drejt bashkimit bankar. Veçoria më e admirueshme e këtyre risive është ritmi i shpejtë i hartimit dhe miratimit të tyre, duke krijuar një efekt “clustering”, brenda Bashkimit European. Edhe vetë Banka e Shqipërisë po ecën shpejt me ndryshimet dhe shtesat përkatëse rregullatore, që synojnë rigjallërimin e huadhënies për ekonominë, që po rritet me ritme tepër modeste, përveç përpjekjeve për përafrim me standardet e Bazel II, e në një të ardhme të afërt, edhe me ato të Bazel III.

Deri këtu duket sikur çdo gjë është në rregull, por natyrshëm lindin disa pyetje: A mund t’i imunizojë rregullimi i skajshëm tregjet dhe sistemin bankar nga rreziqet, duke prodhuar antitruapat e përshtatshëm për një mirëqeverisje të mirëfilltë të veprimtarisë dhe menaxhim të kujdesshëm të rreziqeve? A mos u shkruajtën keq rregullat e mëparshme, apo rregullatorët u treguan miopë? Sigurisht, rregullat dhe rregulloret nuk janë të këqija, por rregullimi i tepërt mund t’i japë oksigjen shprehjes së famshme të Sër Uinston Çerçill: “Nëse vendosni dhjetë mijë rregulla, atëherë do të shkatërrohi të gjithë respektin për ligjin!” Gjithashtu, është e qartë se rregullatorët i miratojnë rregullat e sotme duke u nisur nga e tashmja, por ata kanë mundësi të kufizuara të parashikojnë rrjedhojat e ardhshme të veprimeve të tyre, thjesht për shkak të një fakti të jetës: e ardhmja nuk mund të parashikohet. Kështu, e gjithë industria bankare është e vendosur tashmë në një mjedis rregullator tredimensional. Sa sukses do të kenë këto rregulla e rregulloret? Më e mira do të ishte një mbyllje me pohimin e profesor Piter Ljuin: “Rregullat e suksesshme janë të rralla, kurse sukseset e tregut janë të shumta!”

¹ Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

REBUSI I RREGULLIMIT FINANCIAR



nga Zj. Viktorija PROSKUROVSKA
Këshilltare për çështjet ekonomike
Federata Europiane e Bankave, EBF

Rregullimi bankar, përgjatë gjithë historisë së tij është konturuar, shtrënguar dhe liberalizuar në mënyrë të vazhdueshme. Momente të shënuara janë ato që lidhen me Ligjin Glass-Steagall të vitit 1933 dhe Sistemin e Bretton Woods-it të vitit 1944, valën e risive, që nisi nga vendimi i SHBA-së i vitit 1971, për t'i dhënë fund konvertueshmërisë së dollarit amerikan në Ar, e më pas, liberalizimi i rregullimit bankar, që filloi në fund të viteve '90, në të dyja anët e Atlantikut.

Aktualisht, në kohën e pas krizës së fundit ekonomike e financiare, sektori bankar europian po përjeton një "cunam" rregullator. Në fakt, nga akademikët pranohet se krizat e mëdha shpesh ndiqen nga një ndërhyrje rregullatore shumë shtrënguese (madje e tepruar). Në prag të krizave, disa banka kanë përdorur një levë financiare shumë të lartë, e shkaktuar nga prirja e aksionarëve për të rritur fitimet. Si rrjedhim, bankat pavarësisht modelit të tyre të biznesit, po përballen me një rregullim mjaft të rreptë për një tërësi çështjesh: nga kërkesat për kapital dhe likuiditet, te kufizimet për levën financiare; një mbrojtje më e madhe e investuesve dhe rritje të transparencës; çështjet e qeverisjes (administrimit)

Në të vërtetë, rregullimi nuk është i keq, pasi për ta mbajtur industrinë të sigurt e të shëndoshë, bankat kanë nevojë për një nivel të përshtatshëm rregullimi, por shpeshtësia e krijimit të tij gjatë viteve të fundit, pa një reflektim të mjaftueshëm rreth tij, në të vërtetë nuk është mënyra e duhur në këtë drejtim.

së brendshme dhe shpërblimit; zvogëlimi i përdorimit të derivateve financiarë jashtë bursave, e deri te mënyra se si është strukturuar sektori, e kështu me radhë.

Duke i hedhur një vështrim propozimeve ligjore të bëra nga Komisioni Europian gjatë 3 viteve të fundit, çdokush mund të mendojë se bëhet fjalë për një paketë të re të legjislativonit dhe kuadrit rregullator të BE-së. Faktikisht, që nga viti 2008, vetëm nga Drejtorja e Përgjithshme e Komisionit Europian për Tregun e Brendshëm, u përgatitën mbi 40 propozime të ndryshme ligjore. Stadi aktual i propozimeve të reja rregullatore dhe mungesa e të kuptuarit të ndikimit të këtyre propozimeve, të cilat shpesh duket se mbivendosen apo janë në konflikt me njëri-tjetrin, kanë krijuar një mjedis mjaft kompleks për veprimtarinë e bankave. Si shembull mund të përmendet mënyra se si zbatohet në BE taksa për transaksionet financiare. Për industrinë bankare dhe financiare ekziston një ndjesi se rregullimi zbatohet për shkak të frikës dhe jo si një konturim konstruktiv i një kuadri vizionar e largpamës. Kjo e bën dhe më të komplikuar (të pakuptueshme) situatën për bankat.

Në përpjekje për të mbrojtur depozituesit nga efektet potencialisht të dëmshme të veprimtarisë bankare, entet rregullatore në të gjithë botën këshillohen të ndajnë veprimtarinë financiare me rrezik të lartë nga de-

pozitat (Vickers, Volcker, Liikanen). Megjithëse arsyetimi bazohet në një logjikë të shëndoshë, të tilla ndryshime strukturore në modelet e biznesit të bankave europiane mund të çojnë në pasoja të paparashikuara. Financimi i kapitalit të bankave po bëhet një faktor vendimtar sinjalizues rreth besueshmërisë së tyre në treg. Kjo qasje e tregjeve do të pakësonte nevojën për të vazhduar me masa strukturore. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se rregullimi është i keq. Në të vërtetë, për ta mbajtur industrinë të sigurt dhe të shëndoshë, bankat kanë nevojë për një nivel të përshtatshëm rregullimi. Megjithatë, shpeshtësia e krijimit të tij gjatë viteve të fundit, pa një reflektim të mjaftueshëm rreth tij, në të vërtetë nuk është mënyra e duhur në këtë drejtim.

Është e qartë se politikanët u gjetën të papërgatitur për këtë lloj krize masive, ku çdo problem i shtohet problemeve të mëparshme, duke krijuar një lloj torte helmuese, me të cilët duhej të merreshin politikanët e BE-së. Me falimentimin e Lehman Brothers, pesë vjet më parë, u trondit i gjithë sistemi financiar botëror. Kuadri financiar i BE-së u gjet pothuaj i papërgatitur për këtë "surprizë": në atë kohë nuk ekzistonte një regjim për zgjidhje krizash, ku Bashkimi Bankar, si dhe sistemi i sigurimit të depozitave, nuk ishte i përshtatshëm, për llojin e krizës së vitit 2008. Jo vetëm kaq, por politikat fiskale u lanë

në dorë të politikëbërësve të vendeve përkatëse, e këta vepruan ashtu si mendonin se ishte më e mira. Bankat ishin largpamëse: ato filluan t'i bënin parapritje ndryshimeve rregullatore, që më parë se të hynin në fuqi rregullat kryesore për sektorin financiar, të tilla si: Paketa e katërt e Kërkesave për Kapital (CRD IV / CRR¹). Bankat kanë rritur kapitalin e tyre, duke siguruar nivele të mjaftueshme likuiditeti dhe uljen e levës financiare. Sigurisht, efekti në vijimi CRD IV / CRR është i rëndësishëm, ndonëse i panjohur, pa folur këtu për pjesën tjetër të rregullave që janë në hartim e sipër.

Tabloja bankare po ndryshon jo vetëm në dimensionin e saj rregullator, por gjithashtu edhe në modelin e mbikëqyrjes dhe atë gjeografik/të biznesit. Përveç rregullimit të plotë dhe në thellësi të industrisë, sot një ndryshim kryesor strukturor me rëndësi të madhe është krijimi i Bashkimit Bankar për Eurozonën. Së shpejti, bankat e Eurozonës do të mbikëqyren drejtpërdrejt nga një ent në nivel europian, ndërsa mbikëqyrësit kombëtarë do të heqin dorë nga mbikëqyrja e bankave më të rëndësishme në Eurozonë dhe do të bashkëpunojnë në drejtim të mbikëqyrjes së bankave më të vogla dhe atyre lokale. Krijimi i Bashkimit Bankar do të ndryshojë, në mënyrë të pashmangshme, mënyrën se si do të ushtrohet veprimtaria, në kuadër të përcaktimeve aktuale të rregullave përkatëse (të paktën fillimisht

Komuniteti bankar e pranon se kriza nuk ndodhi për shkak të niveleve të ulëta të kapitalit, por për shkak të menaxhimit jo të mirë të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut konsiderohet gur themeli i çdo banke, i cili tregon se duhet të ekzistojë një ekuilibër i plotë midis përfitueshmërisë dhe kujdesit.

për bankat më të mëdha), mënyrën si do të mbikëqyren bankat, si dhe mënyrën se si do të përcaktohen linjat dhe përmbajtja e raportimit. Çelësi i suksesit të veprimtarisë bankare në të ardhmen e afërt do të jetë aftësia për t'u përshtatur me ndryshimet e reja rregullatore, duke ruajtur marzhe tërheqëse fitimi për investuesit.

Në kushte krize, sektori bankar fillon dhe merr një karakter më kombëtarizues (ndihma shtetërore, fonde kombëtare garancie për depozitat, investime në obligacione të qeverisë, gjithashtu). Për më tepër, ndikimi i një pjese të legjislacionit të ri të BE-së, sikundër dhe kostoja në rritje e tij, ka detyruar disa grupe bankare ndërkombëtare të heqin dorë pjesërisht nga veprimtari të tyre jashtë vendit. Gjithashtu, edhe numri i transakcioneve ndërkufitare po zvogëlohet. Arritjet e bankave në tregun e brendshëm po treten. Ndryshimet rregullatore dhe mbikëqyrëse të sipërpërmendura janë vetëm maja e ajërbergut, në këtë proces gjithëpërfshirës rregullator në industrinë financiare të BE-së. Ajo që pranohet gjerësisht në industrinë financiare të BE-së është se, ndërsa përshtatja me mjedisin e ri rregullator është vërtet e rëndësishme, mbirregullimi do të sillte pasoja të padëshirueshme, jo vetëm për industrinë financiare, por edhe për të gjithë ekonominë si një e tërë. Arbitrazhi rregullator do të ishte një efekt anësor i pashmangshëm, në kushtet e një regjimi rregullator shtrëngues. Ky "efekt i dyshekut me ujë" do ta pengonte bankungun europian, pasi ai do të shkaktonte zhvendosjen e një pjese të rrezikut drejt bankungut "shëmbëlltë" (shadow banking).

Kështu, rreziku sistemik global do të vazhonte, por në një hapësirë më pak të mbikëqyrrur.

Në këto kushte, rrezikojnë të shfaqen disa pasoja të tjera të paparashikuara. Së pari, modeli i bankingut universal që zbatojnë bankat evropiane, vihet në rrezik. Kjo nuk lidhet vetëm me mënyrën si është ndërtuar modeli bankar; kjo lidhet gjithashtu me atë se sa i shërbejnë bankat ekonomisë dhe se si i përdor ekonomia shërbimet financiare (d.m.th., nuk do ketë më "one-stop-shop" për NMV-të). Së dyti, marzhet e fitimit të bankave po tkurren, e kjo është thikë me dy presa, pasi fitimet tkurren për shkak të kostos së lartë të kërkesave të reja rregullatore dhe kërkesave të raportimit. Nga ana tjetër një përfitueshmëri e ulët nënkupton që bankat humbasin interesin e investuesve, duke kërcënuar de facto aftësinë tërheqëse të industrisë bankare të BE-së. Kjo mund të çojë në largimin e një numri të madh të bankash nga BE-ja, drejt juridiksioneve më miqësore për sektorin financiar. Njëkohësisht, rregullimi duhet të fokusohet në objektiva të mirëpërcaktuar. Përveç kësaj, për të rritur financimin me kapital të bankave dhe transparencën e tyre, duhet t'i vihet një theks më i fortë e më i vendosur menaxhimit të rrezikut brenda bankave, si një faktor thelbësor për stabilitetin financiar, rrjedhimisht, për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen. Kjo është një thirrje për sektorin bankar, në mënyrë që të mësojë të përshtatet me normalitetin e ri rregullator, që të ketë sukses në këtë mjedis kompleks, si dhe të ndihmojë BE-në të rindërtojë ekonominë e saj.

1 CRDIV: (Capital Requirements Directive IV/Direktiva IV e kërkesave të kapitalit)
CRR: (Capital Requirements Regulation / Rregullore e kërkesave për kapital)





%interes
për 5 vitet e fundit

Afati i kredisë - 25 vjet
Norma e interesit duke filluar nga
Bono Thesari 12M+1.3%

**Thjesht,
një ofertë
e shkëlqyer!**

RREGULLIMI BANKAR – NJË E ARDHME BANKARE KOMPLEKSE



nga **Dokt. Avis ANDONI**
Pedagoge, UET

Mbështetur në natyrën globale të bankingut, nuk ka alternativë tjetër përveç orientimit në korniza mbikëqyrëse. Në një treg të shtrirë tashmë pa kufij, me një dinamizëm dhe aftësi transformimi natyrshëm drejt rrezikut të lartë për fitim të lartë, përditësimi dhe zgjerimi territorial i një baze mbikëqyrëse, është për t'u parë si kusht kryesor i harmonisë bankare ndërkombëtare. Mbajmë fokusin në BE e mund të numërojmë përpjekje të shumta drejt një unifikimi: Bankën Qendrore Europiane (ECB), Federatën Bankare Europiane (FBE), tre Autoritete të Mbikëqyrjes Europiane, Rregulloret Financiare e Bankare Europiane, Unionin Bankar European etj. Ka shumë pyetje e problematika që ngrihen në gjirin e bankingut në rrafshin europian. Autoriteti Bankar European (EBA), apo (ECB)? Cila është në objektivi? Mbikëqyrje e mirëfilltë apo thjesht rregullim i përbashkët? Deri ku do të penetrohet me rregullim? Faktikisht, aspirata e një bashkimi bankar europian është mjaft ambicioze, por jo e pandërmarrë si nismë, pasi pa bas-

Mënyra e strukturimit të kapitalit si dhe “jastëkët” e shumtë mbrojtës, e vështirësojnë dhe e ngushtojnë fushën e veprimit të bankave ashtu dhe riinduktimin në ekonomi.

hkim bankar dhe mbikëqyrje të përbashkët, asnjë zgjidhje ndaj krizave të mundshme nuk është e mundur. Nën këtë frymë, pas muajsh debate pranë Këshillit të Bashkimit European dhe Parlamentit European, miratohet së fundi “arkitektura” rregullatore bankare europiane CRD IV/CRR, të cilat në harmoni me paketën mbikëqyrëse të Bazel III modifikojnë rregullat mbi kërkesat për kapital në nivel bankash dhe të shoqërive të investimit dhe do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2014.

Nevoja e rishikimit të kërkesave të kapitalit

Përveç pasojave negative nga kriza, u nxorën “mësime” për të çarat e sistemit apo pamja-ftueshmëritë në nivelin e rregullatorëve, si dhe u tregua prekshmëria e sistemit financiar në planin global. Mësimi i parë nxjerr në pah nevojën e përforcimit të bashkëpunimit të autoriteteve monetare, fiskale dhe mbikëqyrëse në rrafsh global. Së dyti, u “zbuluan” institucionet financiare që nuk përthithën dot “tronditjet” e tregut, duke mos mbajtur dot veten e tyre, pasojë kjo e nivelit dhe cilësisë së kapitalit, disponibilitetit të tij, menaxhimit të likuiditetit, si dhe cilësisë së qeverisjes së korporatës. Së treti, dështimet ndërkufitare të grupeve ndërkombëtare ishin një sfidë e pakapërcyeshme vetëm nga autoritetet kombëtare.

Nga Bazel II në Bazel III

Kriza e fundit financiare evidentoi një sërë çarjesh në marrëveshjen Bazel II, që pasoi me një nevojë të lartë të mbështetjes publike për rivendosjen e besimit dhe stabilitetit në sistemin financiar. Këto të çara përfaqësohe-

shin nga: kapital që nuk përthith dot humbjet, menaxhim i dobët i likuiditetit dhe i rrezikut në nivel grupi, si dhe qeverisje e dobët. Propozimi i Bazel III paraqet ndryshime për të mbyllur këto të çara, d.m.th.: *më shumë sasi dhe cilësi kapitali, likuiditet më i balancuar*, si në periudhat afatgjata dhe në ato afatshkurtra, për evitimin e “tharjes” së tregut; *frenimin e levës financiare*, për të mos kompromentuar aftësinë paguese të bankave; *kërkesa kapitali ndaj derivateve, amortizatorët e ruajtjes së kapitalit*, që synojnë një vlerë shtesë të rezervës së kapitalit me cilësi të lartë.

A do e “absorbojë” totalisht CRD IV dhe CRR Marrëveshjen Bazel III? BE, apo vende anëtare të tij, janë kontribuues të mëdhenj në BIS dhe BCBS¹, pra në vetë Marrëveshjen Bazel III,

Bankat do të përballen atëherë me kosto më të larta nga zbatimi i direktivës, fakt që tregon rrezik për bankat e vogla dhe nga ana tjetër këto kosto do të përcillen dhe absorbohen nga klienti fundor, për të mos prekur përfitueshmërinë.

1 BIS: Bank for International Settlements, BCBS: Basel Committee on Banking Supervision.

duke siguruar që problematikat dhe specifikat e bankave europiane kanë qenë të mirëadresuara. Të dyja "grupimet" luftojnë për të njëjtin qëllim, por për dy arsye Bazel III nuk mund të "kopjohet" literalisht në legjislacionin e BE-së: (1) kjo marrëveshje nuk është ligj, pasi përfaqëson një grup standardesh të aprovuara në nivel global nga mbikëqyrës dhe banka qendrore, ndërkohë që (2) kërkesat për kapital zbatohen për banka aktive ndërkombëtarisht, BE-ja i adresohet të gjitha bankave dhe shoqërive të investimit.

Prurjet e CRD IV dhe CRR-së

Në rregulloren e kërkesave për kapital (CRR), shtohet "libri i rregullave unike"², që përfaqëson një grup të vetëm rregullash të përbashkëta në BE, duke harmonizuar kështu rregullat e fushëveprimit dhe ofruar garanci ligjore për çdo aktor tregu. Ndërkohë, në CRR rigjenden elementë të Bazel III, si: paketa e kapitalit dhe rrezikut, paketa e likuiditetit, leva si dhe paketa mbi ekspozimin ndaj kredikërkuesve të vegjël. Për sa i përket CRD IV, këtu mund të evidentojmë më shumë ndryshime: *shpërblimet*, për të shmangur sipërmarrjen e lartë të rrezikut, duke përcaktuar një kufi për *bonus-in* në raport me pagën fikse; *qeverisja*, ku rriten kërkesat për qeverisjen e korporatave, për të për-

Rregullorja dhe direktiva do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën e tregjeve të kapitalit, ku shpërndarja e aktiveve do të ndikohet dukshëm nga kërkesat në sasi e cilësi të kapitalit, duke shtyrë bankat të tërhiqen drejt borxhit afatshkurtër dhe të mirëmbuluar.



mirësuar menaxhimin e rrezikut dhe monitorimin efektiv të mbikëqyrjes; *transparenca* e rritur mbi aktivitetin e bankave dhe fondeve të investimit mbi fitimet, taksimin dhe subvencionet; *diversitet* në kompozimin e anëtarëve të bordeve drejtuese, për të evituar "mendimin në grup" dhe mbikëqyrjen efektive të tij; *amortizatorët e rrezikut sistematik*, që krijojnë një nivel shtesë prej 3-5% të kapitalit bazë, për t'u mbuluar nga rreziqet sistematike jocike; *amortizatorët sistematikë globalë* për institucionet financiare sistematikisht të rëndësishme globalisht, që u kërkohet një detyrim shtesë 1-3.5% të kapitalit bazë, për të mbuluar rrezikun moral dhe abuzimin me paratë e taksapaguesve lokalë në rast dështimi; *amortizatorët sistematikë të tjerë*, që i drejtohen institucioneve të tjera financiare kombëtare me një nivel mbulimi deri në 2% të kapitalit bazë.

Përmbledhtazi, synohet përpilimi i një kuadri ligjor për një mbikëqyrje skrupuloze, që në shumë drejtime ka lidhur me fill të kuq shumë nga aktivet e produktet financiare/bankare, për të forcuar stabilitetin dhe shmangur krizat. Por a do ta shtynte bankingun ky kuadër rregullator kaq strikt në "tundim"? Mënyra e strukturimit të kapitalit dhe "jastëkët" e

shumtë mbrojtës vështirësojnë dhe ngushtojnë fushën e veprimit të bankave dhe riinduktimin në ekonomi. Gjithashtu, kushtëzimet e likuiditetit do të shtyjnë bankat të refuzojnë plot investime në mundësi të ndryshme biznesi, për shkak të ndikimit potencial mbi likuiditetin apo levën, pavarësisht zotërimit të kapitalit të duhur. Pjesë të tjera të direktivës, si: *transparenca* dhe *shpërblimet*, kanë potencialisht ndikim negativ mbi konkurrueshmërinë në sektorin bankar, duke konsideruar faktin që sektorë të tjerë financiarë nuk kanë të njëjtat kushtëzime. Si do të reagojë modeli i biznesit në strategji, qeverisje, procese e sisteme të bankingut, nën tre dimensionet e direktivës (*kapital, levë, likuiditet*)? Faktikisht mund të lindin shumë pyetje në momente ndryshimesh, po nëse shohim tregun financiar/bankar shqiptar, i cili nuk ndodhet ende në nivelet që këto rregullore parashikojnë, pra më pak institucione financiare e më pak produkte, atëherë si do të ishte diskutimi rreth zbatimit të tyre, para se të konkretizohen elementët përbërës? Natyrshëm lind pyetja: dakord me mbikëqyrjen për një treg më të shëndetshëm, por a do ta **formësonin apo deformonin** tregun tonë të tilla rregullore?

² Single rule book.

INVESTIMET E BANKAVE JASHTË SHQIPËRISË – NJË PËRPPJEKJE E KUSHTUESHME

Shtimi i kërkesave për kapital për investimet jashtë do ta bëjë më të shtrenjtë rritjen e këtyre investimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që bankat do përballen me një sfidë të re jo të vogël, për të zëvendësuar këto investime me projekte të shëndetshme huadhënie brenda Shqipërisë.

nga Dokt. Besart KADIA

Në mbledhjen e datës 27.03.2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi disa ndryshime në kuadrin rregullativ, që synojnë përmirësimin e ofertës së kreditimit nga sektori bankar. Banka e Shqipërisë (BSH), konstatoi gjatë vitit 2012 një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së huadhënies nga sektori bankar dhe një rënie e mëtejshme të cilësisë së huadhënies. Huadhënia pësoi një rritje të moderuar për gjatë katër viteve të fundit, me një nivel mesatar prej rreth 10 % në vit, ritëm ky që mund të konsiderohet relativisht i kënaqshëm për situatën ekonomike aktuale, si dhe nëse krahasohet me zhvillimet në vendet e rajonit, që kanë përjetuar ritme të ulëta të huadhënies, madje dhe rënie të tij. Gjithsesi, ky nivel është disa herë më i ulët se ritmi i rritjes së huadhënies në sektorin privat, gjatë viteve 2004-2008, që ishte mesatarisht 66 % në vit.

Nga sa më lart, është për t'u vlerësuar nisma e BSH-së për të nxitur sistemin bankar të sigurojë ritme të larta të rritjes së huadhënies në vend. Kjo paketë krijon stimuj për kanalizimin e fondeve të bankave drejt ekonomisë së vendit, nëpërmjet lehtësimit të kërkesave për kapital për huadhënien dhe nëpërmjet shtrëngimit të kërkesave për investime jashtë vendit. Ndërkohë, që ka një perceptim publik pozitiv për këto masa të BSH-së, ajo që duket se do të ketë më pak efekt në përmbushjen e qëllimeve të BSH-së është pikërisht shtrëngimi për investime jashtë vendit. Pavarësisht se depozitat në monedhë

të huaj, veçanërisht ato në euro janë rritur, huadhënia mbetet e ulët, ndërkohë që rriten investimet e sektorit bankar në produkte të jorezidentëve (kryesisht institucione financiare). Bankat e shpjegojnë këtë me faktin që ato janë të kushtëzuara ta investojnë këtë likuiditet jashtë vendit, për shkak të mungesës së kërkesës për hua në monedhë të huaj, ndërkohë që me lëvizjet e fundit bankat duket se do përballen me një sfidë të re jo të vogël, për të zëvendësuar këto investime me projekte të shëndetshme huadhënie, brenda Shqipërisë.

Sipas AAB-së, investimet jashtë vendit janë një aktivitet jofitimprurës (apo dhe me humbje) për bankat,

Në kushtet kur niveli i huave me probleme është i lartë dhe rritja ekonomike për vitin 2012 vlerësohet në 1.5%, hezitimi i bankave për huadhënie në monedhë të huaj duket i justifikuar. Kjo si pasojë e kërkesës së ulët për hua nga ekonomia reale në vend dhe jo si një shteg shpëtimi, për investime më të mira jashtë vendit.

ndaj duket sikur rritja e koeficientit të rrezikut (në 100 %) për këto investime pritet të ketë efekt modest në rritjen e huadhënies në vend, duke ndikuar më tepër në kërkesën për shtim kapitali nga bankat tregtare, por jo në rritje të huadhënies në vend, të paktën jo në monedhë të huaj. Kjo rritje e kërkesës për kapital për investimet jashtë vendit synon të bëjë më të shtrenjtë rritjen e tyre, duke ulur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit e duke dhënë një efekt negativ mbi bankat. Rritja e pretendimeve ndaj jorezidentëve përgjithësisht pasqyron dobësinë e kërkesës së brendshme për hua, në kushtet e ngadalësimit të rritjes ekonomike të vendit. Konkretisht, në kushtet kur niveli i huave me probleme është i lartë dhe rritja ekonomike, për vitin 2012 vlerësohet në 1.5%, hezitimi i bankave duket i justifikuar, si pasojë e kërkesës së ulët për hua nga ekonomia reale në vend dhe jo si një shteg shpëtimi, për investime më të mira jashtë vendit.

Nga ana tjetër, AAB shpjegon se bankat në Shqipëri janë të angazhuara të sigurojnë kreditimin e nevojshëm të ekonomisë, si aktivitet i tyre parësor dhe i natyrshëm. Në fund të vendimit të saj BSH-ja shpjegon se objektivi i saj qendror është ruajtja e qëndrueshmërisë së sektorit bankar dhe se është e gatshme të identifikojë nevojën për veprime të tjera, në rast se këto masa nuk do të jenë të suksesshme. Në këtë këndvështrim, duket dhe besohet se BSH-ja dhe bankat do ta riadresojnë së shpejti këtë vendim në kushte të tjera.



 04 22 34 096  www.bankacredins.com

Credins Online është shërbimi nëpërmjet internetit që ju mundëson kryerjen e shërbimeve bankare pa qenë nevoja të jeni prezent në bankë, mjafton të keni një kompjuter, celular, smartphone apo tablet.

Me Credins Online ju:

- Vështroni gjendjen e llogarive tuaja.
- Merrni informacione të detajuara, përmbledhje apo historikun e lëvizjeve të llogarive, kredive, depozitave apo kartave tuaja.
- Kryeni transfertat brenda dhe jashtë bankës.
- Kryeni transfertat brenda dhe jashtë Shqipërisë.
- Kryeni Pagesa të faturave utilitare si energji elektrike, ujësjellës, apo pagesa qiraje etj..
- Kryeni këmbime valutore shitje/blerje në monedha të ndryshme.

Për ta përfutur Credins Online mjafton të keni ose të hapni llogari në Credins Bank dhe të paraqiteni në një nga degët tona për tu pajisur me një Kod Përdorimi dhe Fjalëkalim.

Shumë thjesht dhe pa asnjë kosto regjistrimi.



Z. Bozhidar TODOROV
Drejtor i Përgjithshëm,
Fibank Albania

BANKIERI: SI MUND TA PËRMBLIDHNI ME DISA FJALË VITIN 2012 PËR FIBANK ALBANIA?

Viti 2012 ishte një vit shumë i mirë, pasi shënoi pikën e kthesës për Fibank Albania. Arritjet tona kanë qenë impresionuese, duke e vendosur bankën tonë në vendin e parë të sistemit bankar shqiptar për të gjithë elementët e normës së rritjes, për vitin e kaluar. Ajo që e bën suksesin tonë më kuptimplotë është se të gjithë treguesit e ecurisë së bankës dhe rritja në vlerë nominale e tyre, e vendosën bankën tonë midis 4-6 bankave më të mira. Kështu, rritja prej rreth 30 milion euro e aktiveve totale, si dhe rritja thujse 33 milion euro e depozitave, pasqyrojnë një shenjë të qartë besimi ndaj nesh. Gjithashtu, patëm një rritje të huave rreth 43%, më e larta në terma relative dhe e gjashta në vlerë nominale, ndërmjet të gjitha bankave të tjera. Një fakt i rëndësishëm është se ne patëm një rritje të huave, duke mbajtur në rreth 8 % normën e huave me probleme, shifër kjo shumë e ulët për momentin. Mbi të gjitha, gjatë vitit 2012, banka jonë arriti pikën kritike dhe regjistroi një fitim neto prej rreth 700 mijë euro, fitim ky i konsiderueshëm nëse kemi parasysh situatën aktuale ekonomike. Numri i klientëve u rrit me të njëjtën shpejtësi dhe thujse është trefishuar në tre vitet e fundit. Sot ne i shërbejmë më shumë se 40 mijë klientëve. Këto shifra tregojnë rolin që luan Fibank mes bankave më aktive të sistemit dhe në ekonominë shqiptare, pavarësisht nga pjesa e tregut të saj. Ky është një sukses i madh për një bankë në rritje.

BANKIERI: CILAT JANË ARSYET QË ÇUAN NË KËTË VIT TË SUKSESSHËM?

Në këto 4-5 vitet e fundit, ne ngritëm një ekip të mirë profesionistësh, me një nivel bashkëkohor profesionalizmi. Në 3-4 vitet e fundit kemi patur një rritje mesatare vjetore rreth 30% në depozita, huadhënie dhe aktive totale; edhe viti 2012 ndoqi të njëjtën prirje. Gjithashtu, një tjetër arsye e rëndësishme është dhe eksperiencia e bankës mëmë, Fibank-Bullgari, që operon si bankë rajonale në vendet përreth. Këto vende, vetëm pak vite më parë, u përballën me të njëjtat probleme që po kalon Shqipëria sot. Eksperiencia e krijuar në këtë mënyrë, përbën një përparësi të madhe, nga e cila ka përfituar ban-

VITI 2012, NJË VIT I SUKSESSHËM PËR FIBANK ALBANIA

Çdo moment i vështirë, bashkë me sfidat dhe vështirësitë, sjell me vete mundësi të reja dhe ne besojmë se me mbështetjen dhe eksperiencën e bankës mëmë jemi në gjendje t'i shfrytëzojmë ato.

ka jonë. Fibank - Bullgari, që aktualisht është banka e tretë më e madhe në Bullgari dhe banka më e madhe me kapital vendas, është vlerësuar vazhdimisht për përsosmërinë e ofruar në shërbimin ndaj klientit dhe plotësimin e kërkesave të tij. Ne kemi zbatuar me sukses këtu eksperiencën dhe njohuritë, kulturën e korporatës dhe praktikatat më të mira të bankës mëmë, të cilat kanë patur një ndikim të madh në arritjet tona pozitive. Për më tepër, jemi fokusuar në çdo klient të veçantë e kemi ofruar produkte bankare të modeluara, sipas kërkesave të tyre. Ne kemi mbajtur në vëmendje ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe tregtinë me pakicë, të cilën e kemi identifikuar si segmentin tonë të tregut, duke përfituar maksimalisht, meqë jemi një bankë relativisht e vogël. Ne kemi shfrytëzuar potencialin e tregut shqiptar, duke ofruar produkte relativisht të rinj, të tilla si: kartat e kreditit, me të cilat kemi fituar një pjesë të madhe tregu.

BANKIERI: MENDONI SE DHE VITI 2013 DO TË JETË PO AQ I SUKSESSHËM SA VITI I KALUAR, DUKE PATUR PARASYSH SFIDAT QË SISTEMI BANKAR DHE EKONOMIA SHQIPTARE PO KALON AKTUALISHT?

Në mënyrë të qartë, objektivi ynë është të vazhdojmë rritjen dhe siç e përmenda më lart, prej disa vitesh banka po ndjek një prirje pozitive, duke realizuar dhe njohjen e markës. Fibank Albania ka treguar se di të operojë në situatën ekonomike aktuale dhe vazhdon të mbështesë kërkesat e biznesit për financim, duke dhënë kështu kontributin e saj në rritjen ekonomike të vendit. Në rolin tonë si këshillues financiar profesionist, jemi shumë aktivë për të mbështetur biznesin vendas në trajtimin e çështjeve të menaxhimit. Unë do të dëshiroja të përmendja një thënie që personalisht e preferoj, sipas së cilës "çdo moment i vështirë, bashkë me sfidat dhe vështirësitë sjell me vete mundësi të reja". Besimi ynë është se me mbështetjen dhe eksperiencën e bankës mëmë jemi në gjendje t'i shfrytëzojmë këto mundësi, dhe ne e kemi vërtetuar këtë. Ne mendojmë se me rritjen e numrit të klientëve, do të jemi në gjendje të vazhdojmë të kemi rritje të huadhënies dhe ngritje në treguesit e tjerë të performancës.

Shqipëria ende ofron një potencial të madh për rritje dhe zhvillim të mëtejshëm, të cilat do të realizohen vetëm pas përmirësimit të kuadrit ligjor, të cilin bankat, nëpërmjet AAB-së, po e vënë në vëmendje të organeve ligjberëse dhe vendimmarrëse, gjithashtu.

EKZEKUTIMI I KOLATERALIT, NJË TIPAR I RËNDËSISHËM I TREGJEVE FINANCIARE TË SUKSESSHME

Ekzekutimi i kolateraleve do të sillte rezultate pozitive dhe përmirësim të aktivitetit bankar në dy drejtime: zvogëlimin e huave me probleme në përgjithësi, si dhe krijimin e mundësive të reja të kreditimit të blerësve të rinj, që kanë nevojë për financim.

nga Z. Periklis DROUGKAS
Drejtor i Përgjithshëm
Alpha Bank Albania

Në Shqipëri huadhënia për biznesin e madh dhe për individët sigurohet me pasuri të paluajtshme. Në këtë këndvështrim, rritja e huave me probleme për shkak të krizës duhet të pasohej nga ekzekutimi i kolateraleve, që duhet të krijojnë automatikisht mundësi të reja për t'u vlerësuar nga tregu. Me fjalë të tjera, kjo do të kishte qenë "dita e së vërtetës" për kolaterale, që do të tregonte nëse bankat kanë marrë vendime të drejta kur kanë vlerësuar dhe pranuar kolaterale në aktivitetin e tyre huadhënës. Por, duket se "dita e së vërtetës" është e vështirë të vihet në prove këto ditë, e kjo për arsye jo të lidhura me reagimin e tregut, diçka për të cilën përgatitësh për t'u përballur në këtë industri, por për arsye të pazakonta. Kjo u konfirmua dhe nga Banka e Shqipërisë, që e trajtoi këtë çështje së fundi në Forumin Financiar Shqiptar, kur njohu ndikimin e ekzekutimit të kolateralit në axhustimin e ngadaltë të çmimeve të pronave, në përputhje me kushtet e tregut¹.

Kur bëhet fjalë për ekzekutimin e kolateralit, paradoksi qëndron se puna më e mërzitshme dhe më e lodhshme këtu, duket se është procedura ligjore e zbatimit dhe jo mungesa e pjesëmarrësve apo lojtarëve të interesuar të tregut. Kjo ishte diçka që huadhënësit dhe autoritetet rregullatorë nuk e morën parasysh dhe nuk parashikuan se do të përbente një çështje kaq shqetësuese, në një vend që synon të integrohet në Bashkimin Europian. Përveç kësaj, parimet li-

gjore të përdorura në procedurën e ekzekutimit nuk janë subjekt i risive të mëdha e si rrjedhim, në pjesën më të madhe të vendeve nuk përfaqësojnë çështje ligjore, që duhet të adresohen duke përdorur teknika ligjore të sofistikuarra. Ky ka qenë kuadri që bëri që komuniteti bankar të vlerësohte përgjigjen e Qeverisë shqiptare, mbështetur nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore, për të amenduar Kodin e Procedurave Civile. Amendamentet e reja përpiqen të adresojnë deri diku, çështjet e evidentuara nga pengesat në ekzekutimin e kolateralit. Disa nga shqetësimet më të mëdha lidhen së pari me mundësitë e huamarrësit (debitorit), që lejohet të ngrejë një sërë objeksionesh dhe apelimesh, të cilat e konvertojnë "ekzekutimin" në një "proces gjyqësor" kontradiktor. Duhet të theksohet se nuk ka qenë kjo ideja kur kontratat e huas u njohën nga legjislacioni shqiptar në vitin 2001, si tituj ekzekutivë e si rrjedhim krijuan bazën e një sigurie ligjore të kërkuar nga bankat dhe investuesit. Së dyti, gjykatat kanë pasur shumë liri për të dhënë lehtësimit masën e pezullimit, e cila deri në vendimin përfundimtar të gjyqit të

Kur zbatohet siç duhet, praktika e ekzekutimit të kolateraleve ndikon në sjelljet e klientëve që nuk paguajnë dhe i motivon ata të përmirësojnë bashkëpunimin me bankat për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë për pagimin apo ristrukturimin e huave.

lëshuar për këtë çështje e dobëson ekzekutimin. Si rrjedhojë e procedurave të gjata gjyqësore, një karakteristikë e sistemit gjyqësor shqiptar, e vënë në dukje nga shumë institucione ndërkombëtare, për të cilën sigurisht që Shqipëria nuk mund të krenohet, e ka vonuar në mënyrë ekstreme ekzekutimin. Si rrjedhojë, amendamentet e reja që kufizojnë fuqinë e gjykatave për të pezulluar ekzekutimin ndërsa balancojnë të drejtat e klientëve, përfaqësojnë zhvillime të rëndësishme që duhet të vlerësohen. Megjithatë, ka ende çështje për të cilat nevojitet një rregullim më i mirë në këtë drejtim, të tilla si: struktura nxitëse për specialistët e përmbartimit e palidhur me suksesin, e cila përfundon me një shtrembërim.

Në këtë çështje nuk ka vend për keqkuptim; ekzekutimi i kolateraleve nuk është një qëllim në vetvete i industrisë bankare, por një tipar i rëndësishëm i një tregu dhe ekonomie funksionale (të suksesshme) dhe besoj se duke pasur parasysh nivelin e kursimeve dhe depozitave në Shqipëri, tregu ka burimet e nevojshme për të shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga ekzekutimi i kolateraleve. Kur zbatohet siç duhet, praktika e ekzekutimit të kolateraleve ndikon në sjelljet e klientëve që nuk paguajnë dhe i motivon ata të përmirësojnë bashkëpunimin me bankat për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë për pagimin apo ristrukturimin e huave. Gjithashtu, ekzekutimi i kolateraleve do të sillte rezultate pozitive dhe përmirësim të aktivitetit bankar në dy drejtime: zvogëlimin e huave me probleme në përgjithësi, si dhe krijimin e mundësive të reja të kreditimit të blerësve të rinj, që kanë nevojë për financim.

¹ Punimet dhe konkluzionet kryesore të Forumit Financiar Shqiptar, 8 prill 2013.

KOLATERALI FINANCIAR, NJË RISI NË TË DREJTËN SHQIPTARE DHE SFIDAT E ZBATIMIT TË TIJ



nga Zj. Holta ZAÇAJ, LL.M.
Menaxhere e Seksionit
të Shërbimeve Ligjore
Alpha Bank Albania

Rregullimet e reja për kolateralin financiar në ligjin për sistemin e pagesave¹ përbejnë një risi në të drejtën shqiptare, frymëzuar nga rregullimet përkatëse të së drejtës europiane² dhe më gjerë. Këto rregullime plotësojnë dhe modernizojnë të drejtën shqiptare, e cila është bazuar deri më sot në parime të ngurta, lidhur me kolaterale, pa qene të përputhura me realitetin financiar aktual. Në këtë këndvështrim, njohja si kolateral e titujve dhe e parasë (*cash-it* në llogari) dhe vendosja e tyre në një regjim specifik pranimit dhe ekzekutimi, është shumë e rëndësishme dhe meriton të trajtohet ndryshe nga llojet e tjerë të kolateraleve, për vetë faktin se këto lloj pasurish, për shkak të natyrës së tyre ndodhen nën administrimin e institucioneve financiare, që janë të përfshira në aktivitetin

Një aspekt i rëndësishëm që lidhet me rregullimet e reja është se kolaterali financiar parashikohet të krijojë një radhë të re përparësie mbi kolaterale, me qëllim ruajtjen e statusit të kreditorit të siguruar.

huadhënës përkatës. Në këtë kuadër, procedura e ekzekutimit parashikohet të jetë më efiçente dhe pa kosto³, duke e veçuar kolateralin financiar në këtë mënyrë nga procedura tipike e ekzekutimit të kolateralit sipas Kodit të Procedurës Civile⁴. Megjithatë, vlen të përmendet që ekzekutimi rezulton të jetë i thjeshtë dhe efiçent

Pavarësisht rrisë dhe aktualitetit, rregullimet e reja për kolateralin financiar janë të prirura të gjejnë më pak përdorim se çdo të shpresonin bankat të kishin, për shkak të kufizimit të zbatimit të tyre, i cili përcaktohet nga fakti që subjektet, të cilët mund të lidhin një marrëveshje për kolateral financiar janë vetëm personat juridikë.

në rastin e *cash-it*, pasi ekzekutimi ndodh drejtpërdrejt nga banka, që edhe e posedon atë, çka nuk mund të thuhet në rastin e titujve si kolateral financiar. Në një vështrim krahasues mes *cash-it* dhe titujve, ideja e rregullatorit për ekzekutim të menjëhershëm në rastin e titujve është e kufizuar për shumë arsye:

- (i) Titujt nuk mund të jenë në zotërim të bankës, pasi në tregun shqiptar titujt janë në formë të dematerializuar "book entry";
- (ii) Regjistrimi i pronësisë mbi titujt dhe transaksionet me to, duket se është i paqartë për shkak të mungesës së depozitarit qendror të titujve, i cili për analogji do luante rolin e hipotekës për titujt. Aktualisht aksionet mbahen në regjistrin e posaçëm të aksioneve të vetë shoqërive dhe regjistrohen në QKR dhe në QRA. Vlen të përmendet që transferimi i pronësisë së titujve kushtëzohet nga regjistrimi i titullarit të ri në regjistrin e shoqërisë⁵, ndërkohë që pasqyrimi i transferimit të pronësisë mbi titujt në QKR⁶, sipas ligjit, ka vetëm karakter deklarativ. Po kështu, pavarësisht parashikimit përkatës në VKM për krijimin e QRA-së⁷, pasqyrimi në QRA i transferimit të pronësisë së tituj-

1 Ligji Nr. 133/2013 "Për sistemin e pagesave".

2 Direktiva 2002/47/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit date 6 /6/2002 mbi kolateralin financiar e ndryshuar me Direktiven 2009/44/EC Parlamentit Europian dhe e Këshillit date 6/5/2009.

3 Neni 1, 28,29 Nr. 133/2013 "Për sistemin e pagesave".

4 Pjesa e katërt, Kreu 2, Kodit të Procedurës Civile.

5 Neni 117/2 dhe neni 119, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

6 Neni 74 (2) Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe neni 43/4, 44/b Ligji Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit - QKR".

7 VKM Nr. 112, date 19.2.1996 " Per krijimin e shoqerise anonime" "Qendra e Regjistrimit te Aksioneve - QRA"

CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405

ve rezulton të jetë i papërshtatur me konceptin e legjislacionit për shoqëritë tregtare, që e lidh kapitalimin e pronësisë së aksioneve dhe fitimin e të drejtave bazë si ajo e votës dhe ajo për dividend me lidhjen e kontratës përkatëse dhe për këtë shkak, ekzekutimi i titujve si kolateral financiar është shumë i vështirë për t'u realizuar, në krahasim me ekzekutimin e *cash-it*;

- (iii) Bankat për shkak të kufizimeve ligjore⁸ nuk kanë mundësi të ekzekutojnë në favor të tyre titujt, pra ekzekutimi i këtij lloji kolateral është i lidhur me gjetjen e një blerësi tjetër, ndryshe nga *cash-i*, të cilin bankat e ekzekutojnë drejtpërdrejt në favor të tyre;
- (iv) Vlera e titullit të ekzekutueshëm mbetet gjithashtu një çështje që do të ndikonte në ekzekutim, duke qenë se titujt nuk janë të listuar dhe të tregtueshëm në bursë dhe ato pranojnë edhe në transaksionet e zakonshme me vlerën sipas kapitalit fillestar (me kosto historike)⁹. Ekzekutimi i tyre me këtë vlerë do të bënte që pjesa e pashlyer e huas së siguruar me këtë lloj kolateral të ishte shumë më e madhe se sa vetë vlera reale e aksioneve dhe për këtë arsye ky lloj ekzekutimi do

Problemi më i madh me të cilin do të përballen bankat do të jetë vakuumi i krijuar nga ndryshimet ligjore të këtij ligji, të kryera në frymën e përputhjes së tij me ligjin e ri të sistemit të pagesave, që e kanë bërë të pazbatueshme vendosjen e barrës siguroese për titujt në pronësi të individëve dhe për pasuri të paprekshme të tjera, siç janë: "faturat e arkëtueshme", një praktikë kjo gjerësisht e përdorur nga sistemi bankar.



të ishte i kundërshtueshëm në gjykatë. Duke u bazuar në sa më sipër, lypset të jetë e nevojshme ndërhyrja edhe në ligjet përkatëse, për të realizuar efektin e dëshiruar lidhur me ekzekutimin e titujve si kolateral financiar.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm që lidhet me rregullimet e reja, është ai që kolaterali financiar parashikohet të krijojë një radhë të rë përparësie¹⁰ mbi kolaterale, me qëllim ruajtjen e statusit të kreditorit të siguar, kundrejt pretendimeve nga të tretët në situatë normale, por edhe duke siguruar veçimin e kolateralit financiar në një skenar falimenti. Megjithatë kjo përparësi është e pamundur, për shkak të radhës së preferencës, të parashikuar sipas nenit 605 të Kodit Civil. Pra në thelb, përparësia në lidhje me kolateralin financiar ka të bëjë vetëm me eficientën e ekzekutimit të tij në aspektin procedural, por jo në lidhje me radhën e përparësisë, për shkak të parimit të hierarkisë së normës juridike.

Përmbledhtazi, vlen të theksohet gjithashtu se, pavarësisht rrisë dhe aktualitetit, rregullimet e reja të kolateralit financiar janë të prirura të gjejnë më pak përdorim se çdo të shpresonin bankat të kishin, për shkak të kufizimit të zbatimit të tyre, i cili përcaktohet nga fakti që subjektet, të cilët mund të lidhin një marrëveshje për kolateral financiar janë vetëm personat juridikë. Duke

pasur parasysh se titujt në Shqipëri përgjithësisht rezultojnë të jenë në pronësi të individëve dhe praktika e shoqërive të varura është jo shumë e përhapur, bën që marrëveshja e kolateralit financiar me tituj të jetë pak e zbatueshme.

Po kështu, kolaterali financiar me para "*cash*", ka rezultuar të jetë i zbatueshëm në praktikë kur ortakët/aksionarë të shoqërive kanë pasur depozita dhe me to kanë dashur të sigurojnë detyrime huaje të shoqërive, ku ata janë ortakët/aksionarë. Kështu që në praktikë kolaterali financiar me "*cash*" mund të kufizohet vetëm në rastin e shoqërive të lidhura, kur njëra shoqëri siguron detyrime të shoqërisë se lidhur, praktike që nuk është përfaqësuese në tregun shqiptar.

Në përfundim mund të thuhet se, me gjithë rregullimet e reja mjeteve e sigurimit të huave do të mbeten serish ato me klasikët në Kodin Civil dhe ato të parashikuara në ligjin për barrat siguroese. Problemi më i madh me të cilin do të përballen bankat do të jetë vakuumi i krijuar nga ndryshimet ligjore të këtij ligji, të kryera në frymën e përputhjes së tij me ligjin e ri të sistemit të pagesave, që e kanë bërë të pazbatueshme vendosjen e barrës siguroese për titujt në pronësi të individëve dhe për pasuri të paprekshme të tjera, siç janë: "faturat e arkëtueshme"¹¹, një praktikë kjo gjerësisht e përdorur nga sistemi bankar.

⁸ Neni 59, Ligji Nr. 9662, date 18.12.2006 "Per bankat ne Republiken e Shqiperise".

⁹ Neni 105,107, Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare".

¹⁰ Neni 29, Ligji Nr. 133/2013 "Per sistemin e pagesave".

¹¹ Neni 1, Ligji Nr. 132/2013 "per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 8537, date 18.10.1999 " per barret siguroese" I ndryshuar

KULTURA E RREZIKUT SI NDIHMESË NË DREJTIMIN EFEKTIV TË RREZIKUT NË BANKA



nga Zj. Artiola AGALLIU

Zv.Drejtores,

Departamenti i Menaxhimit të Riskut

ALPHA BANK ALBANIA

Prej vitesh drejtimi i rrezikut është bërë një nga kërkesat më kryesore për një qeverisje efektive të bankave. Nga ana tjetër, kërkesat për kapital, bazuar në nevojën e përcaktimit të tij mbi bazën e rreziqeve që përballojnë, kanë shtuar trysninë mbi bankat për një drejtim sa më efektiv të tyre. Bankat sot kanë ndërtuar sisteme të brendshme dhe kanë angazhuar staf, për të identifikuar, vlerësuar, matur dhe trajtuar të gjitha rreziqet me të cilat ato përballen, duke i kushtuar të njëjtën rëndësi. Sot ato janë të afta të matin e të vlerësojnë rreziqet, si në kushte normale të veprimtarisë bankare dhe të tregjeve bankare e financiare, ashtu edhe në kushte jo normale, madje dhe në situata të skajshme. Ato kanë kaluar nga matjet klasike të rreziqeve të bazuara në shumatat e parashikuara, në metoda më të sofistikuara, duke përfshirë jo vetëm qëndrimin e drejtuesve, sidomos të këshillave drejtuese të bankave, por dhe qëndrimin e aksionarëve ndaj rreziqeve.

Megjithë këto hapa pozitive në procesin e drejtimit të risqeve, rreziqet dhe sjellja ndaj tyre nuk është kuptuar drejt nga të gjithë palët në

Pasurimi i kulturës së rrezikut, bashkë me elementët e tjerë të drejtimit të rrezikut, si: politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme, sistemet, teknikat, teknologjia e përdorur etj., mund të konsiderohet si promotor i zhvillimit, për një drejtim sa më efektiv të bankave

këtë proces, duke u nisur nga punonjësit e bankave e madje deri te nivelet më të larta të hierarkisë. Kriza më e fundit financiare ka nxjerrë në pah, midis të tjerave, përveç nevojës së përmirësimit të funksionit të drejtimit të rrezikut, edhe nevojën e krijimit dhe të pasurimit të kulturës së rrezikut.

Funksioni i drejtimit të rrezikut dhe roli i tij në bankë

Funksioni i drejtimit të rrezikut është një prej funksioneve më të rëndësi-

Rreziqet dhe procesi i drejtimit të tyre duhet të mirëkuptohet nga të gjithë punonjësit, në çfarëdo pozicioni të ndodhen ata dhe kjo gjë, më mirë se asgjë tjetër, arrihet nëpërmjet nxitjes dhe promovimit të një kulture të përshtatshme rreziku në bankë, e cila duhet të bazohet në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike të gjithë punonjësve dhe palëve të tjera të përfshira.

shme në strukturën e bankës. Gjatë viteve të fundit të shekullit të kaluar, roli i drejtimit të rrezikut në institucionet financiare të vendeve të zhvilluara ka njohur rritje domethënëse, ndërkohë që në Shqipëri ky zhvillim është një fenomen i dekadës së fundit. Sigurisht, kjo lidhet dhe me zhvillimin e vetë sistemit bankar, i cili akoma nuk ka arritur nivele të krahasueshme me vendet e zhvilluara. Megjithatë, gjasat janë që boshllëku të mbushet për një kohë të shkurtër. Kërkesat për nxitjen e zhvillimit të këtij funksioni kanë qenë të vazhdueshme, si nga bankat ashtu dhe nga autoriteti rregullues, madje ky i fundit ka ndërmarrë edhe angazhim institucional, duke miratuar gjatë vitit të kaluar rregulloren: "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre". Nga këndvështrimi i drejtimit të rrezikut, kjo rregullore solli dy risi kryesore: (1) përkufizon qartë tolerancën e rrezikut të bankës, duke u kërkuar niveleve më të larta drejtuese, këshillit drejtues dhe drejtorisë "të njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të bankës", si dhe paralelisht "të nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi"; (2) përcakton nevojën e krijimit të komitetit të rrezikut, si një prej komiteteve më të rëndësishme, që duhet të raportojë drejtpërdrejt te këshilli drejtues i bankës. Nëpërmjet kësaj kërkesë, autoriteti rregullues përcakton qartë rolin dhe rëndësinë e funksionit të drejtimit të rrezikut, si funksion bazë

në drejtimin e bankave.

Nga ana tjetër, gjatë viteve të fundit, kërkesat e vetë bankave për zhvillimin e rolit të drejtimit të rrezikut kanë qenë më të hershme dhe sigurisht janë rritur. Këto shihen me prioritet të lartë, duke qenë se funksioni i drejtimit të rrezikut ka rol kyç në suksesin apo dështimin e kontrollit të brendshëm të bankës dhe së bashku me funksionin e auditimit, janë "garancia" e aksionarëve të bankave. Nëse më parë funksioni i drejtimit të rrezikut shpesh ngatërrohej me funksionin e raportimit apo dhe me atë të audituesit dhe nuk shihej si një funksion më vete, por thjesht integrohej në proceset e procedurat e brendshme të bankës, sot roli dhe pavarësia është e garantuar. Kërkesat gjithnjë e më rritje të drejtuesve të bankave ndaj njësisë së drejtimit të rrezikut, përfshirja e kësaj njësie në shumë procese vendimmarrëse ekzistuese apo të reja, të konsideruarit e saj si një pikë kyçe, si nga audituesit e brendshëm apo të jashtëm, ashtu dhe nga autoriteti rregullator, investimet e bankave gjithnjë e më shumë në sisteme apo teknologji që i shërbejnë drejtimit të rrezikut etj., e dëshmojnë këtë zhvillim. Tashmë pjesa dërrmuese e bankave në Shqipëri kanë në strukturën e tyre organizative një njësi të veçantë për drejtimin e rreziqeve, ose minimalisht kanë eksperte të caktuar, që u është caktuar ky funksion.

Kultura e rrezikut, garanci për drejtimin efektiv të rrezikut

Termi "kulturë e rrezikut" në bankë i referohet tërësisë së vlerave, burimeve, dijeve dhe kuptimit për rrezikun që kanë (apo ndajnë) një grup individësh, në veçanti punonjësit e bankave ose grupime të tjera brenda bankës. Interpretimi apo kuptimi praktik i një koncepti të tillë kërkon zbrëthimin dhe analizën e ndikimeve të ndërsjellta të të gjithë faktorëve të përfshirë në këtë përkufizim, ashtu si dhe faktorët e tjerë që ndikojnë




tërthortazi në to. Nga zbrëthimi i konceptit, kuptohet se kultura lind nga qëndrimi dhe etika personale e individëve interesmbajtës në bankë. Në të vërtetë, secili prej nesh ka një qëndrim personal ndaj rrezikut, që në kombinim me etikën personale, formojnë sjelljen e individit. Tërësia e sjelljes së individëve brenda një grupi (p.sh.: grupi i punonjësve apo grupime të tjera brenda bankës), formojnë sjelljen e grupit. Me termin sjellje, si në nivel individit ashtu edhe në nivel grupi, kuptohen sjelljet e përsëritura dhe jo thjesht sjellje "të izoluar" apo që ndodhin rrallë. Gjithashtu, qëndrimi dhe sjellja e individit apo e grupit në bankë, ashtu si në çdo mjedis pune tjetër, ndikohet nga kultura mbizotëruese e grupit. Skematikisht, ndërlidhja e këtyre faktorëve jepet në skicën e mëposhtme, bashkësia e të cilëve formojnë kulturën e rrezikut të bankës.

Kultura e rrezikut ndihmon në drejtimin efektiv të rrezikut në ban-

ka, duke ndikuar ndonjëherë më shumë se dhe vetë procesi i drejtimit të rrezikut. Në fakt, kjo kulturë ndikon pozitivisht në:

- komunikimin e qartë të strategjisë së rrezikut të bankës dhe tolerancës së saj për rrezik,
- sigurimin e standardeve të larta të komunikimit, transparencës dhe ndarjes së informacionit në bankë,
- kuptimin dhe përshkallëzimin e shpejtë vertikal të rreziqeve të identifikuar, nga nivelet më të ulëta drejt niveleve më të larta drejtuese të bankës.

Të gjithë këta faktorë, kanë një rol të pazëvendësueshëm në mbarëvajtjen e procesit të drejtimit të rrezikut në bankë. Në fakt, ky proces nuk është i lidhur ekskluzivisht me njësinë e drejtimit të rrezikut, as vetëm me strukturat më të larta drejtuese dhe vendimmarrëse në bankë. Paralelisht me to, një proces efektiv i drejtimit të rrezikut realizohet vetëm me anë të gjithëpërfshirjes së punonjësve dhe individëve apo grupeve të tjera në bankë. Të gjithë punonjësit dhe drejtuesit në bankë duhet të ndjejnë se drejtimi i rrezikut është një përgjegjësi e secilit. Për këtë arsye, pasurimi i kulturës së rrezikut, së bashku me elementët e tjerë të drejtimit të rrezikut, siç janë: politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme, sistemet, teknikat, teknologjia e përdorur etj., mund të konsiderohet si promotor i zhvillimit për një drejtim sa më efektiv të bankave.





DEPOZITA



Koha ecën.....keni mundësinë e artë me hapjen e depozitës më të re pranë Bankës Credit Agricole Shqipëri, t'i shtoni të ardhurat tuaja!

PARTNERITETET PUBLIK-PRIVAT (PPP) DHE RAPORTIMI FINANCIAR

Ndonëse në Shqipëri ende nuk ka një udhëzim të qartë për kontabilizimin dhe raportimin nga entet e sektorit publik, lidhur me pasurinë subjekt i marrëveshjeve koncensionare, një ndihmesë në këtë drejtim mund të jetë mbështetja në kuadrin e IASB-se, në standardin e marrëveshjeve të qirasë dhe sugjerimet e Bordit të IPSAS.

nga **Prof. Asoc. Dr. Hysen ÇELA**
Kryetar i Këshillit Drejtues, IEKA



Z. Kledi KODRA, FCCA
Udhëheqës i Departamentit të Auditimit,
PwC - Shqipëri

Në kuadër të prirjes së sotme, ku vazhdimisht qeveritë po tërhiqen nga kryerja e drejtpërdrejtë e detyrave administrative, si dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët, edhe në Shqipëri po rritet me ritme të shpejta partneriteti publik - privat (PPP). Gjithnjë e më shumë qeveritë sot po përballen me sfidën e ndërtimit të infrastrukturës dhe lehtësive të tjera publike, që duhet t'i përgjigjen rritjes së kërkesave të popullatës dhe gjithashtu, ato po ndeshen dhe me nevojën për meremetimin e infrastrukturës dhe lehtësive publike ekzistuese, që janë përkeqësuar kryesisht për shkak të shyrjes në kohë të mirëmbajtjes së tyre.

Tipar dallues i zhvillimeve të sotme në vendin tonë, është rritja e numrit të marrëveshjeve të PPP-ve të lidhura e të atyre në proces, për realizimin e objekteve të ndryshme të infrastrukturës, për shfrytëzimin eficient të minierave, ndërtimin e HEC-ve, të qendrave dhe lehtësive të ndryshme publike, të shërbimeve të ndryshme publike etj. Marrëveshjet PPP marrin forma të ndryshme, të cilat ndryshojnë sipas shkallës së përfshirjes të sektorit privat dhe sipas mjeteve që përdoren për realizimin e tyre. Një formë specifike e këtij partneriteti janë marrëveshjet koncensionare (MK), që dallojnë nga format e tjera të marrëveshjeve PPP, për faktin që rreziku dhe përfitimet që shoqërojnë ndërtimin, zotërimin

Trajtimet kontabël dhe raportimet përkatëse financiare për marrëveshjet koncensionare nga operatorët privatë mbulohen nga IFRIC 12 i Komitetit të Interpretimeve të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për “Marrëveshjet Koncensionare të Shërbimeve”. Nëse raportimi financiar i kësaj pasurie do bazohej vetëm mbi pronësinë ligjore, nuk do të ishte e mundur të sigurohej një raportim financiar që pasqyron me besnikëri aktivin, bazuar në parimin që “substancia ekonomike mbizotëron mbi formën ligjore”.

dhe shfrytëzimin e aktivitetit (pasurisë) subjekt i marrëveshjes, së bashku me kontrollin mbi të, ndahen në një shkallë të madhe mes njësisë së sektorit publik dhe asaj të sektorit privat që hyjnë në marrëveshje. Ndarja e këtyre aspekteve të aktivitetit/pasurisë, si dhe kompleksiteti i transaksioneve e ka bërë shpesh të

paqartë raportimin financiar, si nga ana e entiteteve publike, ashtu edhe atyre private. Shembuj të tillë mund të jenë: shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e një rruge nga një shoqëri private, përkundrejt një tarife, prodhimi dhe shpërndarja e pasaportave kombëtare, prodhimi i pullave të akcizës, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e parkingjeve të mëdha, ndërtimi dhe shfrytëzimi i hidrocentraleve etj. Në jo pak raste, për të mos thënë në shumicën e tyre, kryerja e këtyre marrëveshjeve nga sektori privat kërkon edhe bashkëpunimin e këtij sektori me bankat, për të siguruar mjetet e nevojshme financiare (siç është për shembull rasti i HEC-eve), ku garancia për huamarrjen mund të jepet goftë nga sektori publik, ashtu dhe nga agjencitë apo donatorët e ndryshëm. Në këto kushte, raportimi financiar nënkupton informacion të besueshëm për shumë palë të përfshira.

Ndonëse në Shqipëri ende nuk ka një udhëzim të qartë për kontabilizimin dhe raportimin nga entet e sektorit publik, lidhur me pasurinë subjekt i marrëveshjeve koncensionare, një ndihmesë në këtë drejtim mund të jetë mbështetja në kuadrin e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB Framework), në standardin e marrëveshjeve të qirasë dhe sugjerimet e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (IPSAS). Mungesa e rregullimeve specifike për këtë



çështje, mund të sjellë divergjenca në mënyrën e raportimit të pasurisë/aktivit ose shërbimit. Madje mund të ketë edhe raste kur kjo pasuri të mosraportohet fare si e tillë, as nga sektori publik e as nga ai privat.

Fokusi këtu do të jetë vetëm në çështjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar nga perspektiva e enteve të sektorit publik, pra të ofruesit, duke i dhënë një konsideratë të kufizuar operatorëve të këtyre marrëveshjeve. Kjo pasi trajtimet kontabël dhe raportimet përkatëse financiare për marrëveshjet koncesionare nga operatorët privatë mbulojnë nga IFRIC 12, i Komitetit të Interpretimeve të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për "Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimeve". Nëse raportimi financiar i kësaj pasurie do bazohej vetëm mbi pronësinë ligjore, nuk do të ishte e mundur të sigurohej një raportim financiar që pasqyron me besnikëri aktivin, bazuar në parimin që "substancia ekonomike mbizotëron mbi formën ligjore". Kështu, del domosdoshmëri të analizohen si marrëdhëniet mes palëve, ashtu dhe aktivi apo aktiviteti subjekt i marrëveshjes.

Sipas IPSAS, aktivet përkufizohen, si: "burime që kontrollohen nga një ent, të cilat vijnë nga veprimtaritë e kryera në të kaluarën, nga të cilat priten hyrje të mundshme të përfitimeve ekonomike të ardhshme apo potenciale". Nocioni i kontrollit mbi burimet është paraqitur qartë në përkufizim. Nisur nga përkufizimi, që ofruesi të raportojë pasurinë, su-

bjekt i marrëveshjes së koncesionit, si një aktiv ai duhet të ketë jo vetëm kontrollin mbi pasurinë, por dhe të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike ose shërbimet e mundshme. Kontrolli mbi përdorimin e pasurisë është parimi kyç që trajtohet dhe në përfundimet e arritura në KIRFN 12 (IFRIC 12). Sipas këtij parimi, operatori privat nuk duhet të raportojë si një aktiv të tijin një pasuri, subjekt i marrëveshjes që rregullohet nga ky interpretim. Sipas këtij interpretimi, operuesi privat nuk njihet pronën si aktiv, por një aktiv jomaterial ose një aktiv financiar, që pasqyron të drejtën që atij i është dhënë nga ofruesi për të përdorur pronën, apo për të marrë flukse të kontraktuara monetare. Sipas Bordit të IPSAS-eve, natyra e kriterëve që përfshihen në fushën e zbatimit të KIRFN 12, përgjithësisht është e përshtatshme për të përcaktuar nëse ofruesi ka kontroll në themel (të rëndësishëm) mbi pasurinë sipas këtyre marrëveshjeve, për qëllime të raportimit financiar. Këto kriterë të konsideruara së bashku tregojnë se:

(a) ofruesi do të ketë një të drejtë të vazhdueshme për të kërkuar që me pasurinë të operohet në një mënyrë të atillë që të përmbushen objektivat për shërbimin ndaj publikut gjatë gjithë jetës së marrëveshjes dhe më gjerë, dhe

(b) aftësia praktike e operatorit për të shitur ose lënë peng pronën është e kufizuar.

Pavarësisht kontrollit të operatorit mbi ofrimin e aspekteve të caktuara të shërbimeve të gjeneruara nga

pasuria, përdorimi i përgjithshëm i kësaj pasurie mbetet i kufizuar për objektivin e ofruesit të përcaktuar në marrëveshje. Për më tepër, ofruesi i koncesionit kontrollon aspekte kyçe operative të pasurisë, si p.sh.: tarifat që duhet të aplikohen për përdorimin e saj. Nëse plotësohen kriteret që janë të ngjashme me ato në KIRFN 12, përgjithësisht do të pranohet se operatori operon me pasurinë në emër të ofruesit, dhe se ky i fundit ka kontrollin përfundimtar mbi pronën.

Bazuar në udhëzimet e IPSAS 23 dhe IPSAS 6, mund të argumentohet se, nëse kontrolli në themel i koncesiondhënësit mbi pasurinë është i ngjashëm me kontrollin rregullator, vetëm ky kontroll nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur konceptin e kontrollit që jepet në përkufizimin e një aktivi për qëllime të raportimit financiar të ofruesit. Për shembull, qeveria mund të transferojë një sipërfaqe toke të një universiteti publik, duke përcaktuar që toka do të përdoret vetëm për të ndërtuar kampusin e universitetit. Sipas IPSAS 23, pavarësisht këtij përcaktimi, universiteti publik (në këtë shembull "përdoruesi") e kontrollon tokën dhe do ta paraqesë atë si aktiv në pasqyrat e tij financiare. Gjithashtu, universiteti duhet që të njohë një detyrim, nëse përcaktimi do të konsiderohet si një kusht, që do të thotë se, në qoftë se toka nuk përdoret për qëllimin për të cilin ajo është dhënë, atëherë ajo do t'i kthehet pronarit të ligjshëm. Rezultatet e raportimit financiar në këtë shembull mund të duken në konflikt me udhëzimet e trajtuara më sipër, lidhur me kontrollin mbi pasurinë e kësaj marrëveshjeje, ku pala që imponon kufizime mbi përdorimin e aktiveve (ofruesi) dhe jo përdoruesi i aktivitetit (operatori) konsiderohet se e kontrollon pasurinë për qëllime të raportimit financiar. Dallimi kyç ndërmjet shembullit të transferimit të tokës për universitetin dhe marrëveshjes së shërbimeve koncesionare është se koncesiondhënësi mban kontrollin e interesit të mbetur në pasurinë në themel të marrëveshjes deri në fund të saj. Në marrëveshjet tipike si ato për të cilat folëm më sipër, aktivi në fund të marrëveshjes nuk i kthehet transferuesit. Edhe aty ku paracaktimi është kusht, me plotësimin e këtij kushti aktivi mbetet tek operatori, pra në rastin e universitetit, në momentin që toka do të përdoret për të ndërtuar kampusin, aktivi (toka) mbetet për t'u raportuar në pasqyrat financiare të Universitetit.

(vijon në numrin tjetër)

KONSIDERATA TEORIKE DHE ASPEKTE TË MBIKËQYRJES SË SISTEMIT TË PENSIONEVE – MUNDËSITË NË SHQIPËRI



nga Zj. Enkeleda SHEHI
Kryetare
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,
AMF

Fondet e pensionit bëjnë pjesë tek burimet më të mëdha kapitale në shumë vende, duke tejkaluar në disa raste dhe 100% të PBB-së. Ky kapital mund të ketë shumë efekte pozitive në zhvillimin e një vendi, duke ofruar likuiditet për tregjet financiare dhe duke ndikuar në zhvillimin e investuesve institucionalë. Fondet e pensionit dhe investuesit institucionalë mund të ushtrojnë ndikim drejtpërdrejt në qeverisjen e korporatave, gjë që i ndihmon vendet e ndryshëm të tërheqin dhe të mbajnë kapitale. Po kështu, nëpërmjet mekanizmave të besueshëm afatgjatë të kursimit dhe të mbrojtjes sociale, fondet e pensionit sjellin efekte pozitive, duke zgjeruar horizontet e planifikimit dhe reduktuar incentivat për sjellje kundër produktive.

Sipas Broeders, Kortleve, Pelsser dhe Wijckman¹s, sistemet e pensioneve mund të përvijohen sipas tre dimensioneve:

- (1) Përfitimet e pensionit: (i) pagesa të garantuara (skemat me përfitimet të përcaktuara fikse), kundrejt pagesave të pagarantuara (skemat me kontribute të përcaktuara

Kontributi i shtyllës së tretë është i papërfillshëm në raport me ekonominë shqiptare, kështu që reforma në shtyllën e II-të do ta gjallëronte sistemin e pensioneve, duke kontribuar në adresimin e sfidave afatgjata që e shoqërojnë atë.

fikse), siç është dhe modeli i pensioneve vullnetare në Shqipëri.

- (2) Metoda e financimit: të kapitalizuara kundrejt PAYG. Sistemet PAYG janë të ndjeshëm ndaj zhvillimeve demografike dhe makroekonomike, ndërsa sistemet e kapitalizuara ndaj rrezikut të inflacionit dhe të investimit.

- (3) (Niveli i ndarjes së rrezikut: pa ndarje rreziku kundrejt ndarjes së rrezikut nga palët e interesit. Palët e interesit, që kualifikohen për të qenë mbajtës të rrezikut janë: sponsori, pjesëmarrësit aktualë dhe pjesëmarrësit e ardhshëm. Në vija të përgjithshme dallohen dy tipe ndarje të rrezikut; brenda një brezi (ang. intragenerational) dhe midis brezave (ang. intergenerational).

OECD-ja identifikon tre shtylla, të njohura zakonisht si shtyllat e siste-

mit të pensioneve, përkatësisht: shtylla e parë, që është e detyrueshme dhe përbëhet nga elementi i rishpërndarjes; shtylla e dytë, që është gjithashtu e detyrueshme dhe përbëhet nga elementi të kursimit dhe shtylla e tretë, që është vullnetare.

Shumë vende europiane e kanë shtyllën e dytë, por në secilin vend mund të ketë skema të ndryshme. Sipas OECD-së veçohen katër skema brenda shtyllës së dytë:

- (1) *Skemat me përfitime të përcaktuara* (angl. defined benefits - DB), ku e ardhura e pensionit varet nga numri i viteve të kontributeve dhe të ardhurat individuale. Skemat DB janë të kapitalizuara dhe risqet ndahen midis palëve të shumta të interesit.

- (2) *Skemat me kontribute të përcaktuara* (angl. defined contributions - DC), ku kontributet derdhen në llogari individuale. Grumbullimi i kontributeve dhe të ardhurave nga investimi i tyre, përkthehen në pagesa pensioni. Skemat DC janë të kapitalizuara, por nuk ka ndarje rreziqesh mes palëve të interesit.

- (3) *Skemat me pikë* (angl. point schemes - PS), ku punonjësit fitojnë pikë bazuar në të ardhurat që ata kanë çdo vit. Në pleqëri, shuma e pikëve të pensionit shumëzohet me një vlerë të caktuar të një pike, për të përcaktuar nivelin e përfitimit. Këto skema klasifikohen si skema PAYG, pa ndarje të rrezikut midis palëve të interesit. Në disa përjashtime, këto skema konceptohen dhe si të kapitalizuara.

- (4) *Llogaritë teorike* (angl. notional

Objektivi themelor i mbikëqyrjes së pensioneve është që fondi i pensionit të jetë në gjendje të përmbushë angazhimet apo pritshmëritë që i janë komunikuar anëtarëve, në linjë me përfitimet dhe rreziqet ndaj të cilave fondi është i ekspozuar.

¹ Dirk Broeders, Niels Kortleve, Antoon Pelsser and Jan-Willem Wijckmans: *The design of European supervision of pension funds*, Network for Studies on Pensions, Aging and Retirement, Shkurt 2012.



Kredia Hipotekore 5 Yje

Interes fiks për vitin e parë

5.9% Euro & **7.9%** Lekë

Shlyerje para afatit me **komision 0**



Fibank
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al



accounts - NDC), ku kontributet regjistrohen në llogari individuale 'teorike' (gjendja e llogarisë ekziston vetëm në regjistrat e institucionit që e menaxhon llogarinë) dhe mbi llogarinë zbatohet një normë kthimi. Në pleqëri, kapitali "teorik" i mbledhur konvertohet në pension. Skemat NDC klasifikohen si sisteme PAYG, ku rreziku ndahet me sponsorin.

Në varësi të modelit që do të përzgjidhet, konturohen dhe instrumentet mbikëqyrës që një ent rregullator duhet të ketë në dispozicion për mbikëqyrjen e këtij segmenti.

Sfidat e rregullatorëve të pensioneve sa vijnë e rriten në kushtet e globalizimit. Konkureshmëria kombëtare, zhvillimi i tregut, eficienta dhe siguria e anëtarëve të fondeve të pensionit, janë sfida për të cilat autoritetet mbikëqyrëse duhet të mendojnë njëkohësisht në ditët e sotme, duke i shtuar faktin që pensionet janë të ndjeshëm dhe nga vëmendja politike. Në kuadër të këtij realiteti, modelet mbikëqyrëse po orientohen më tepër te rezultatet, menaxhimi i rrezikut, eficienta dhe transparenca. Mbikëqyrja e pensioneve bazohet kryesisht në dy shtylla kryesore, që janë ose të fokusuar te transaksionet, ose te mbikëqyrja strukturale. Në rastin e parë, fokusi është te rreziqet e agjencisë dhe standardet proceduriale, ndërsa në rastin e dytë theksi është te kufizimet sasiore, subjektet financiare nën këndvështrimin e rreziqeve sistematike dhe portofolit. Përherë e më tepër theksi po vihet tek menaxhimi i rrezikut dhe orientimi drejt rezultateve, sesa tek strukturat dhe tek rregullat. Sfida më e madhe që rre-

gullatorët kanë për t'u adoptuar ndaj këtyre ndryshimeve, janë strukturat dhe kapacitetet për të mbajtur dhe tërhequr staf me ekspertizë të lartë financiare dhe teknike, fleksibilitet i lartë në adoptimin e strukturave në përputhje me dinamikat e zhvillimit të tregjeve dhe autonomia e plotë e këtyre institucioneve.


Po në Shqipëri?

Shkalla e ulët e zhvillimit të shtyllës së tretë në Shqipëri, për vetë faktin që është skemë vullnetare, si dhe mungesa e shtyllës së dytë, shoqërohet me një kosto oportune të lartë të angazhimit të kapaciteteve mbikëqyrëse nga ana e AMF-së. Megjithatë, vitet e fundit AMF-ja ka ndërmarrë një sërë hapash pozitivë në reformimin e shtyllës së tretë të pensioneve. Ligji nr. 10197, dt. 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", vendosi standardet e nevojshme për administrimin me efektivitet dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve private vull-

netare, duke krijuar në këtë mënyrë një eksperiencë të re, sipas standardeve europiane. Skema e përzgjedhur është me kontribute të përcaktuara, e kapitalizuar, në linjë me prirjet e fundit globale.

Sfida më e vështirë për AMF-në në vijim do të jetë siguri i pavarësisë financiare dhe fleksibilitetit struktural, me qëllimin kryesor mbajtjen dhe tërheqjen e stafit me ekspertizë të lartë teknike dhe adoptimin dinamik të strukturave në linjë me zhvillimin e tregjeve të mbikëqyrura. Pavarësisht sfidave në konceptimin e një reforme të drejtë të shtyllës së dytë të pensioneve, një reformë e tillë do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e vendit në tërësi dhe në veçanti të tregut të kapitalit, duke krijuar kapitale të reja për t'u investuar në sistemin financiar. Niveli i ulët i mjeteve nën menaxhim në shtyllën e tretë, prej vetëm 314 mln lekë dhe pjesëmarrja relativisht e papërfillshme prej 7,289 anëtarësh, e bëjnë akoma më të domosdoshme reformën e sistemit të pensioneve.

Siç shihet dhe nga grafiku, në Shqipëri kontributi i shtyllës së tretë është i papërfillshëm në raport me ekonominë e vendit. Kështu, vetëm një reformë në shtyllën e dytë do ta gjallëronte sistemin e pensioneve në Shqipëri dhe do të kontribuonte në adresimin e sfidave afatgjata që e shoqërojnë atë. Kështu, në afatgjatë transferimi i një pjese të sistemit të pensioneve tek sektori privat, ul ndjeshëm rrezikun politik, duke e transferuar përgjegjësinë te manaxhimi dhe përgjegjësia individuale. Sa më i fortë të jetë roli dhe rëndësia e shtyllës së dytë në sistemin e pensioneve, aq më të ndjeshme do të jenë përfitimet e reformës, duke rritur presionin drejt menaxhimit të kujdesshëm dhe uljes së deficitit të sistemit në tërësi.



MJETET E ANALIZËS PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT - MATRICA E KLASIFIKIMIT TË RREZIKUT FIZIK



nga Z. Roland TASHI
Kryetar,
Komiteti i AAB-së për Sigurinë
Bankare

Siguria në sistemin financiar dhe atë bankar, duhet konsideruar si faktor i rëndësishëm strategjik, pasi ajo ndikon ndjeshëm te bizneset e përfshira në këtë sistem, duke qenë përcaktues në ecurinë dhe mbarëvajtjen e tyre. Menaxhimi i rrezikut në bankë duhet vëzhguar në një optikë të integruar, që nënkupton analizën e shumë faktorëve dhe detajeve të brendshme e të jashtme, që e prodhojnë atë dhe që e ekspozojnë institucionin ndaj rrezikut. Pavarësisht se banka konceptohet si një institucion i vetëm, ajo përbëhet nga shumë njësi biznesi dhe punonjës të shpërndarë në të gjitha këto njësi. Rreziku i bankës duhet vlerësuar si shumatore analitike e të gjithë faktorëve që mbartin rrezik, një numër i madh i të cilave kanë vështirësi në parashikim, e të tjerë gati të paparashikueshëm.

Prirja e sotme e bankave për të qenë sa më pranë klientit, për t'i shërbyer sa më "miqësisht" atij, duke zbatuar për këtë qëllim hyrje të lira dhe sportele të hapura, ndikon në shtimin e elementëve të rrezikut. Në këtë këndvështrim, drejtimit të bankës i mbetet detyra e vështirë të balancojnë këtë prirje, me nevojën për të rritur nivelin e mbrojtjes së punonjësve që veprojnë në sportele dhe ambientet e brendshme të bankës gjatë situatave dhe ngjarjeve abuzive e kriminale. Integrimi financiar në rritje i popullsisë, afrimi i individëve

Analiza e nivelit të rrezikut nuk është proces që kryhet vetëm në fazën e planifikimit të një objekti me funksione bankare, por ajo duhet të ndjekë në mënyrë dinamike të gjitha zhvillimet, ngjarjet dhe ndryshimet në infrastrukturën e zonës urbane ku vepron banka.

gjithmonë e më shumë me bankat, diversiteti i planimetrive të objekteve bankare, dhe i mënyrave të mbrojtjes të teknikës që bankat aplikojnë, mënyrat dhe format e sofistikuar që përdor krimi për grabitjen e një banke, përbëjnë elementë që kërkojnë analiza specifike të faktorëve që favorizojnë, shtojnë apo reduktojnë rrezikun, si dhe kushtëzojnë gjetjen e rrugëve e mënyrave për ta njohur dhe vlerësuar atë.

Bankat kanë mjetet dhe modelet e analizës për vlerësimin e rrezikut të grabitjes, por një nga mënyrat e mundshme është ndërtimi dhe plotësimi i "Matricës së klasifikimit të rrezikut", që ndihmon në krijimin e një tabloje të qartë të elementëve dhe faktorëve që e favorizojnë, si dhe në përcaktimin e nivelit të tij.

Si mund të përcaktohet niveli i rrezikut të një objekti, në fazën kur ai përzgjidhet për t'u kthyer në bankë, apo kur zhvillon veprimtarinë si bankë, në mënyrë që të planifikohen masa mbrojtëse ndaj veprimeve abuzive kriminale? Bankat kanë mjetet dhe modelet e analizës për vlerësimin e rrezikut të grabitjes, por një nga mënyrat e mundshme është ndërtimi dhe plotësimi i "Matricës së klasifikimit të rrezikut", që ndihmon në krijimin e një tabloje të qartë të elementëve dhe faktorëve që e favorizojnë, si dhe në përcaktimin e nivelit të tij. Ajo është një tabelë komplekse, që plotësohet me të gjithë ato elementë që banka gjykon se "prodhojnë" rrezik e që kanë një peshë të caktuar specifike të shprehur në përqindje. Llogaritja e nivelit të çdo elementi në tabelë, përcakton nivelin e rrezikut, që vlerësohet me shifrat e rrezikut: 1 (i ulët), 2 (i mesëm) dhe 3 (i lartë).

Disa prej elementëve që duhen vendosur në matricë, për të përcaktuar nëpërmjet saj nivelin e rrezikut të objektit, jepen më poshtë:

- *Ngarkesa kriminale në qytetin, zonën që do të veprojë banka.* Këto të dhëna jepen nga prokuroria në raportimet vjetore legale të saj. Një zonë urbane me nivel të lartë krimi dhe prirja për shqetësime sociale ndikon dukshëm në nivelin e rrezikut.
- *Pozicioni i objektit në qytet, apo vendosja e tij në raport me zonën gjeografike rreth tij.* Objektet e vendosura në zona periferike, duhet të konsiderohen me "rrezik

të lartë”; objektet që janë pranë komisariateve të policisë dhe në rrugët e patrullimit, kanë nivel më të ulët rreziku.

- **Mbrojtja e objektit me punonjës sigurie.** Ky është kusht i Bankës së Shqipërisë; megjithatë vendosja e këtij shërbimi, brenda dhe jashtë njësive të biznesit, kombinimi, studimi dhe vlerësimi se ku dhe si duhet të kryhet ky shërbim, rrit nivelin e sigurisë.
- **Pozicionimi i sporteve në raport me hyrjen e objektit bankar.** Sportelet që nuk janë të orientuara në drejtim të hyrjes ndikojnë në rritjen e nivelit të rrezikut gjatë ngjarjeve kriminale dhe grabitjeve.
- **Vrojtimi i portës hyrëse të objektit nga punonjësit e sporteve dhe supervizori i shërbimeve.** Njësitë e biznesit që konceptohen me sportele të “fshehura”, prej të cilave nuk vëzhgohet porta hyrëse dhe qëndrimi i klientëve, duhen vlerësuar me “rrezik të lartë”, pasi kjo mënyrë organizimi ndikon në fshehjen dhe kryerjen e shpejtë të grabitjes.
- **Ndërtimi i sporteve dhe mënyra e funksionimit të tyre.** Sportelet

e hapura, pa struktura mbrojtëse fizike, duhen vlerësuar me “risk të lartë”, pasi janë favorizuese ndaj akteve të grabitjes. Aplikimi i tyre duhet të shoqërohet me shtimin e masave mbrojtëse në zonën hyrëse të njësive.

Ky element i fundit meriton një koment më gjatë, për arsye të ndikimit që ai ka gjatë ngjarjeve kriminale me pasoje grabitjen e bankave. Në periudhën 2000-2012 në sistemin bankar shqiptar kanë ndodhur 35 vepra kriminale me objekt grabitje, prej të cilave 28 ose 80 % e tyre, kanë rezultuar të realizuara. Në të gjitha rastet, objekt grabitje kanë qenë njësitë bankare, sportelet e të cilave janë konceptuar të “hapura” dhe hyrjet për në objekt të lira. Në këtë këndvështrim, elementët e matricës së sigurisë që trajtojnë hyrjen në objekt dhe mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të sporteve, duhen trajtuar me shumë kujdes, pasi ato kanë peshën më të madhe specifike në përcaktimin e ekspozimit ndaj rrezikut dhe evidentimin e nivelit të tij. Duhet kuptuar se, sofistikimi i sigurisë fizike të sporteve mbron vetëm personelin që ndodhet brenda tyre, ndërsa aplikimi i hyrjeve të kontrolluara për në bankë,

me sisteme fizike dhe elektronike të tipeve të ndryshme, mbron jo vetëm punonjësit por dhe klientët që ndodhen brenda bankës. Aplikimi i hyrjeve të kontrolluara në banka, “ndihmon” balancën në favor të argumentimeve të biznesit, të cilët kanë prirje të jenë sa më komunikues me klientët, duke kërkuar përdorimin e sporteve të hapura, pa xhama dhe struktura të tjera të mbrojtjes fizike.

Në matricën e klasifikimit të rrezikut mund të shtohen dhe elementë të tjerë, që ndikojnë në përcaktimin e rrezikut, si: natyra e ndërtimeve dhe sistemi i rrugëve e kalimeve rreth një objekti bankar, mundësia e largimit të shpejtë pas grabitjes, përqendrimi i madh i individëve pranë degës, si efekt i stacioneve të qarkullimit publik, qendrave tregtare, sasia dhe limitet e parave që mbahen në sportele etj. Duhet kuptuar se analiza e nivelit të rrezikut nuk është proces që kryhet vetëm në fazën e planifikimit të një objekti me funksione bankare, por ajo duhet të ndjekë në mënyrë dinamike të gjitha zhvillimet, ngjarjet dhe ndryshimet në infrastrukturën e zonës urbane ku vepron banka.

MATRICA E KLASIFIKIMIT TË RREZIKUT

Objekte të bankës	Ngarkesa kriminale në qytet (të dhëna vjetore të Prokurorisë)	Pozicioni i objektit në qytet, qendër/periiferi/zonë rurale	Mbrojtja e objektit me punonjës sigurie	Pozicionimi i sporteve në raport me hyrjen e objektit	Vrojtimi i hyrjes nga punonjësit në sportele	Ndërtimi, modeli dhe funksionimi i sporteve	Mënyra e hyrjes në objekt	Planimetria e zonës urbane, mundësia për tu larguar	Sasia e parave në sportele	PUNËT TOTALE	Vlerësimi i rrezikut në objekt	Rekomandime për rritjen e nivelit të sigurisë			
												Ndryshimi i mënyrës së hyrjes, Aplikimi i hyrjeve të kontrolluara (sisteme kataz, busull)	Aplikimi i sporteve me nivel sigurie (sportele të mbyllura, 1/2 xham)	Organizimi i shërbimeve të sigurisë (shërbim sigurie brenda dhe jashtë)	Reduktimi i cash-it në sportele (pakësimi i vlerave monetare në sportele)
Objekti "A", Tiranë	10%	10%	8%	12%	12%	18%	18%	6%	6%	100%	Rrezik i lartë				
Objekti "B", Berat	1	2	1	3	2	2	3	3	1	2.1	Rrezik i mesëm				
Objekti "C", Sarandë	3	1	1	1	1	2	3	2	1	1.8	Rrezik i mesëm				

Rrezik i ulët:	1 ÷ 1.3	0.00
Rrezik i mesëm :	1.3 ÷ 2.3	1.30
Rrezik i lartë:	2.3 ÷ 3	2.30
		0.00

SË BASHKU

Ndërtojmë marrëdhënie që zgjasin



ICB është banka Boutique ku çdo klient është mbi të gjitha një partner në një marrëdhënie të gjatë.

Shumë nga sipërmarrjet më të mëdha në Shqipëri kanë zgjedhur ICB për financim të shpejtë, interesa konkurrues por sidomos për lidhjen profesionale dhe shërbimin e shkëlqyer që ICB ofron si një partner serioz. Nevojat e biznesit janë unike dhe në një Bankë Boutique si ICB ato trajtohen dhe mbeten të tilla. Unike. Kjo është marrëdhënia që zgjat.

www.icb.al
☎ 068 408 8000

Zyra Qendrore:
International Commercial Bank
Rr. Murat Toptani, Qendra Eurocol, Tirana, Albania

Për informacione të mëtejshme ju lutemi
na vizitoni në degën më të afërt të
International Commercial Bank,
në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lushnjë



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat

MARRËVESHJA EUROPIANE PËR STRUKTURIMIN APO LIKUIDIMIN E BANKAVE NË KRIZË



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
President & Drejtor
i Shkollës Doktorale
Universiteti Europian i Tiranës, UET

Në kuadrin e masave dhe reformave drejt realizimit të një bashkimi bankar evropian, në datën 27 qershor 2013, nën moton se “duhej bërë gjithçka që të mos përsëritet më çdo lloj krize bankare e ngjashme me krizën qipriote”, ministrat evropianë të financave arritën “in extremis” një kompromis dhe marrëveshje të rëndësishme, duke pranuar një seri rregullash e masash për “të rivendosur ekuilibrin financiar apo likuiduar bankat në vështirësi e situatë falimentimi”.

Efektet e krizës financiare dhe veçanërisht kostoja e lartë që BE-ja pagoi për mbështetjen e bankave të saj në vështirësi (1.600 miliardë euro, ose 13% të PBB-së vjetore të saj për periudhën 2008-2011), bëri që reflektimet dhe rregullat e reja të kërkonin “eliminimin e kostove të kësaj krize, shtimin e përgjegjshmërisë së bankave në aktivitetin e tyre, rritjen e rezistencës së sistemit bankar ndaj krizës, dhe veçanërisht zvogëlimin e peshës negative dhe komplikimet që ato shkaktonin në rritjen e borxheve sovraane në Eurozonë dhe BE”. Në kuadrin e themeleve mbi të cilat po ngrihet bashkimi bankar evropian të tilla, si: mbikëqyrje e unifikuar për të gjitha bankat e BE-së; ngritja e një sistemi uniform për mbrojtjen

e depozituesve dhe ekonomisë nga krizat bankare; krijimi i një fondi evropian për emergjencat apo zgjidhjen e krizave bankare; ndryshimin e disa rregullave të rëndësishme që orientojnë aktivitetin e bankave etj., marrëveshja e re mbi financimin e bankave në vështirësi apo falimentim u konsiderua menjëherë si “shumë e rëndësishme për stabilitetin financiar të BE-së”, si një “gur themeli në përpjekjet e BE për të prishur rrethin vicioz ndërmjet bankave dhe borxheve sovraane”. Sipas presidentit të Eurogrup-it, z. Jeroen Dijsselbloem: “nëse një bankë ka probleme, ne kemi tashtë në dorë një tërësi rregullash unike në gjithë Europën për të vendosur


Nga koncepti dhe praktikat e mbështetjes nga jashtë (bail out), Europa kërkon të shkojë drejt “shpëtimit nga brenda - bail in”, pra u arrit të ndërtohet një sistem mbrojtës që kombinon një kuadër të ri rregullash unike me fleksibilitetin e nevojshëm, që mban në konsideratë veçoritë kombëtare.

Kjo marrëveshje konsiderohet si etapa më e rëndësishme drejt unionit bankar evropian, duke hapur rrugën etapës tjetër, asaj të krijimit të një mekanizmi rregullues evropian për bankat – SRM.

se kush duhet ta paguajë faturën”.

Këto rregulla të reja parashikohen të hyjnë në fuqi, pas miratimit nga Parlamenti Evropian, duke filluar nga viti 2018. Në këtë kuadër, me këtë arsenal masash e sistem të unifikuar, realizohet me sukses rikapitalizimi, ose dhe “likuidimi korrekt” i bankave në krizë, p.sh.: disa aktivitetet të një banke mund të transferohen apo strehohen nëpërmjet një banke tjetër të quajtur “bankë urë” në gjirin e një banke specifike, që i menaxhon ato në perspektivë. Po kështu krijohet mundësia që nëpërmjet instrumentit “bail-in” të konvertohen në kapital apo të amortizohen disa pjesë të pasivitetit të bankave në krizë apo falimentim.

Debati dhe qëndrimet e kundërta, të ndeshura deri tani, sintetizoheshin në faktin se “cili duhet të paguante koston e krizave në banka të ndryshme: fondet publike apo vetë bankat?” Për të evituar pagesat tërësore apo pjesore nga fondet publike, apo nga kontribuesit/depozituesit, në rastet kur një bankë duhet të ristrukturohet apo likuidohet, ministrat e financave të Eurogrup-it ranë dakord që pagesat të bëhen sipas hierarkisë së mëposhtme: aksionarët e bankës, kreditorët më të mëdhenj të saj me shkallë më të ulët pretendimesh, zotëruesit e obligacioneve të rangut të lartë të pretendimeve dhe së fundi, depozituesit që zotërojnë depozita mbi 100.000 euro, pra mbi shumën e garantuar nga legjislacioni evropian në rast falimentimi bankash. Sipas ministrit francez të financave, z. Mos-



covici, "ky përbën një ndryshim drastik, një kalim nga fondet publike te paratë e kontribuesve/depozituesve, nga buxhetet kombëtare te vetë sektori financiar, që duhet të jetë në gjendje t'i zgjidhë vetë". Ndërkohë dhe ministri italian i ekonomisë, z. Saccomani, nënvizon se "bëhet fjalë për një kompromis të rëndësishëm që kontribuon për thyerjen e binomit të rrezikshëm rrezik bankar - rrezik borxhi sovran". Nga koncepti dhe praktikata e mbështetjes nga jashtë (bail out), Europa kërkon të shkojë drejt "shpëtimit nga brenda - bail in". U arrit të ndërtohet një sistem mbrojtës që kombinon një kuadër të ri rregullash unike me fleksibilitetin e nevojshëm që mban në konsideratë veçoritë kombëtare. Ashtu si edhe në rastin e "recetës europiane" për përbalimin e krizës qipriote, që shkaktoi shumë polemika dhe dyshime për lëvizje e transferime spekulative ndërmjet bankave në shtete apo kontinente të ndryshme, depozitat deri në 100.000 Euro do jenë në çdo rast të garantuara dhe të shpëtuara.

Në të gjithë diskutimet për këtë vendim të rëndësishëm, vendet e BE-së u pozicionuan në dy qëndrime të kundërta: në të parin, të përfaqësuar nga Franca, Italia, Suedia dhe Brita-

nia e Madhe, mbrohej pozicioni se: "nuk mund të jemi kaq drastikë në një rregull të përbashkët e ngurtë, por duhet të pranojmë një lloj fleksibiliteti rast pas rasti për banka e vende të ndryshme të BE-së". Franca këmbënguli sidomos në: "mbrojtjen që duhet të gëzonin depozituesit individualë dhe depozitat e ndërmarrjeve të vogla e të mesme", duke i përjashtuar ata nga detyrimi për të përbaluar kostot e falimentimit apo rristrukturimit". Nga ana tjetër qëndron Gjermania, Holanda dhe Finlanda, që mbrojnë pozicionin se: "rregullat duhej të ishin sa më rigorozë dhe sa më unike për gjithë vendet e BE-së, në mënyrë që të dekurajohej e shmangej çdo paqartësi, lidhur me rrezikun bankar dhe çdo lëvizje spekulative investimesh apo depozitash nga një vend në tjetrin", që të dekurajohej sa më shumë "varja e shpresave te paratë publike". Për kancelaren gjermane Angela Merkel, "shantazhi i tipit *too big to fail* nuk mund t'i detyrojë pa fund vendet anëtare që të rikapitalizojnë bankat me miliarda euro nga paratë publike". Vendet nordike ishin më të "vendosura që të mos përdorej fjala progres në ecurinë e procesit të unionit bankar evropian, nëse nuk shikonin në këtë proces angazhimin dhe

përfshirjen e investuesve privatë".

Vendet që dëshironin fleksibilitetin duhej të praninin rregullin për t'u imponuar aksionarëve dhe kreditorëve të mëdhenj të bankave që të paguanin minimalisht 8% të shumës së pasivit të bankës në rristrukturim apo likuidim". Nëse realizohet ky kusht, atëherë këto banka mund të shpresojnë që të ndërhyjë "fondi kombëtar i zgjidhjes së krizave", apo nëse është e nevojshme edhe "burime të tjera financiare kombëtare e europiane", qëllimi kryesor i të cilave do të jetë "rikapitalizimi i drejtpërdrejtë i bankave nëpërmjet MES (mekanizmi evropian i stabilitetit)". Në të gjitha rastet, arrihet në përfundimin se kjo lloj ndërhyrje nuk mund të jetë më e madhe se 5% e pasivit të bankave. Modalitetet e ndërhyrjes së MES dhe fondit të shpëtimit të Eurozonës kanë qenë vazhdimisht objekt "grindjesh" mes Francës dhe Gjermanisë. Ngërçi kryesor qëndronte në gjetjen e koherencës ndërmjet aplikimit të një mekanizmi të drejtpërdrejtë për rikapitalizimin e bankave nga ana e MES dhe përjashtimin e MES nga loja e fleksibilitetit kombëtar. Ndërkohë që gjermanët përjashtonin çdo lloj shpëtimit me fondet publike, francezët kërkonin gjetjen e mundësive që MES, në raste të veçanta, të futej në veprim në ndihmë të bankave në vështirësi.

Si përfundim, në tekstin e marrëveshjes figuron dhe mundësia e mbrojtjes së depozitave mbi 100.000 Euro, si dhe depozitat e plota të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Nëse humbjet e bankave janë më të mëdha se 8% e pasiveve të tyre, humbje që paguhen nga aksionarët dhe investuesit e mëdhenj në këto banka, atëherë ekziston mundësia që të futet (në raste të veçanta) në lojë MES, duke mos e shtrirë detyrimin për të mbuluar humbjet te depozituesit, qofshin këta dhe me depozita mbi 100.000 Euro. Por siç u nënvizua më lart, kjo ndërhyrje nuk mund të jetë më e madhe se 5% e pasivit të bankave, e lidhur ngushtë me shkallën e fleksibilitetit që i lihet çdo vendi anëtar në zgjidhjen e krizave bankare, në kuadrin e adoptimit të direktivës "Bank Recovery and Resolution Directive (BRRD)". Kjo marrëveshje konsiderohet si etapa më e rëndësishme drejt unionit bankar evropian, duke i hapur rrugën etapës tjetër, asaj të krijimit të një mekanizmi rregullues evropian për bankat (Single Resolution Mechanism, SRM).

ALPHA BANK - ALBANIA

“Së Bashku, e ardhmja është më e bukur”

Në kuadër të “Ditës së Vullnetarizmit të Alpha Bank”, më datë 26 maj, punonjësit e Alpha Bank Albania vizituan pavijonet pediatrike në Vlorë, Durrës, Kukës dhe Librazhd. Me mbështetjen e bankës, në këto spitale u rristruar mjedise të ndryshme, si dhe u dhuruan pajisje të ndryshme. Drejtori i Përgjithshëm i Alpha Bank - Albania, z. Periklis Drougkas, tha se është shumë e rëndësishme të organizohen aktivitete të tilla dhe se ai shpreson që ky akt human të tërheqë vëmendjen e duhur dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të kontribuojnë për të përmirësuar kushtet e spitaleve në Shqipëri.

Festivali i Kitarës

Alpha Bank Albania ishte një prej mbështetësve të Festivalit të Parë Ndërkombëtar të Kitarës, i cili u zhvillua në muajin maj 2013 në Universitetin e Arteve. Në festival interpretuan më shumë se 60 artistë dhe studentë nga: SHBA, Belgjika, Gjermania, Zvicra, Shqipëria, Tajlanda, Kroacia, Mal i Zi dhe Kosova.



BKT

BKT mbështet ekspozitën “Kohë dhe Vende: Stambolli - Me vepra nga Koleksioni i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë”

Më 30 maj 2013, në Galerinë Kombëtare të Arteve u çel ekspozita me titull: “Kohë dhe Vende: Stambolli - Me vepra nga Koleksioni i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë”, e cila vjen para publikut në sajë të bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Turqisë, Galerinë Kombëtare të Arteve, Institutin e Kulturës Yunus Emre dhe Bankën Kombëtare Tregtare.

BKT mbështet sezonin turistik “Verë 2013” në Orikum

Bashkia Orikum startoi zyrtarisht sezonin turistik, “Verë 2013”, më datë 01 qershor 2013. Ky aktivitet u sponsorizua nga Banka Kombëtare Tregtare, si edhe nga disa sponsorë të tjerë, me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.



CREDINS BANK

Shtresa në nevojë - Si çdo vit, Credins Bank u gjend pranë shtresave në nevojë, duke ofruar ndihmë të konsiderueshme ushqimore për Kryqin e Kuq Shkodër.

Komuniteti - Credins Bank mundësoi ndërtimin e një lulishteje model në hyrje të qytetit të Kavajës.

Institucione - Credins Bank ka mbështetur mbarëvajtjen e aktivitetit të institucioneve publike, si p.sh.: Bashkinë Ballsh dhe Z.R.P.P Lezhë, Shërbimin Social Shtetëror si dhe spitalin “Shefqet Ndroqi”.

Sporti - Banka zgjodhi mbështetjen për sportin në qytetin e Vlorës dhe blerjen e një sasive të konsiderueshme topa basketbolli për ekipin “Flamurtari”. Gjithashtu, mund të përmendet mbështetja financiare për Kampionatin Mbarëkombëtar të Boksit, për Kupën “Zemra e Tironës”, ekipin kampion të Volejbollit për Meshkuj “Studenti” dhe ekipin kampion të Volejbollit për Femra “Tirana”.

CREDIT AGRICOLE

Festivali i Artit për Fëmijë

Credit Agricole Shqipëri mbështeti këtë vit Festivalin e Artit për Fëmijë, të organizuar më datë 25 maj 2013. Ky edicion i festivalit u zhvillua në komunitetin e Bashkisë Kamëz, në Pallatin e Kulturës, me pjesëmarrjen e fëmijëve në nevojë. Gjatë aktivitetit u zhvillua një konkurs me tematikën: “Arti im, si një udhëtim”. Fëmijë të moshave 7-15 vjeç u ndanë në 4 grupe, sipas moshave, të drejtuar nga 4 artistë profesionistë. Grupi i moshave më të rritura u fokusua në punën jashtë godinës së Pallatit të Kulturës, përmes ndërhyrjes në mjedis me anë të pikturës, me qëllim për ta kthyer atë në një mjedis më të bukur artistik.



INTESA SANPAOLO BANK - ALBANIA

Live ART - Konkurs Pikturë në Artin Bashkëkohor - Intesa Sanpaolo Bank- Albania organizoi të parin Konkurs Pikturë në Artin Bashkëkohor "Live ART". Pas raundit të parë të vlerësimit juria ndërkombëtare do të përzgjedhë 25 finalistët, punimet e të cilëve do jenë pjesë e 5 ekspozitave në qytetet më të mëdha të vendit. Banka thekson përmes këtij konkursi fuqinë e artit në krijimin, transferimin dhe ruajtjen e vlerave shoqërore, duke pranuar njëherazi fuqinë e tij transformuese.

Event me rastin e "Ditës së Jetimit" - Intesa Sanpaolo Bank - Albania mbështeti organizimin e një dreke për 125 fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës. Aktiviteti u organizua me rastin e "Ditës së Jetimit" më datë 20 maj 2013, nga shoqata "Martirët e Policisë së Shtetit", në të cilën bëjnë pjesë 267 familje.

"Shqiptarët për njëri-tjetrin" - Nismë dhurimi për fëmijët në nevojë - Për të dytin vit radhazi punonjësit e bankës morën pjesë në nismën e organizuar nga Fondacioni i Katarit në Shqipëri, për t'u ardhur në ndihmë me rroba, libra, lodra e pajisje fëmijëve jetimë e familjeve në nevojë. Shumë kolegë dhuruan atë që mundën, ndërsa banka dhuroi 30 libra për nisjen e hapave të para të edukimit financiar të fëmijëve me titujt: "Çfarë bëjnë bankat? Si të shpenzosh para? Si të kursesh para?"

Grupi i Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut të Intesa Sanpaolo Bank - Albania - Në datat 30-31 maj, në dy degët më të mëdha të bankës: pranë zyrave qendrore në Bllok dhe në rrugën e Barrikadave rreth 26 kolegë dhuruan gjak për fëmijët talasemikë, nën moton: "Dhuroni Gjak të Shpëtoni një Jet! Dhurata më e mirë për 1 Qershorin!"

Panairi i Punës & Studimit: "Work & Study" - Intesa Sanpaolo Bank - Albania, prezantoi në panairin e organizuar 4-6 prill, mundësitë e punësimit për studentët dhe specialistët në fushat e IT dhe Retail-it. Banka mbështet vazhdimisht burimet njerëzore të kualifikuara, duke iu ofruar atyre mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm profesional.

Dita Ndërkombëtare e Mjedisit - Fushata dyjavore drejtuar klientëve dhe punonjësve për ndërgjegjësim mbi temën e përzgjedhur këtë vit nga UN: "Think-Eat-Save" (Mendo - Ushqehu - Kurse), u ideua në përshtatje me imazhet e fushatës së Kombeve të Bashkuara. Thënie ndërgjegjësuese u sollën në shqip, për të tërhequr më lehtësisht vëmendjen e konsumatorit shqiptar, përmes banner-it në faqen e internetit të bankës dhe posterave në të gjithë degët e saj.



PROCREDIT BANK

ProCredit Bank feston 1 Qershorin

Me rastin e Festës së 1 Qershorit, ProCredit Bank organizoi aktivitete të ndryshme me fëmijët dhe prindërit, të cilat kishin për synim theksimin e rëndësisë së kulturës së kursimit afatgjatë tek prindërit. Nëpërmjet lojërave ndërvepruese edhe "ketrit ProKid", fëmijëve iu shpjegua rëndësia që kursimi ka për realizimin e planeve në të ardhmen.

"Takime të hapura" pranë ProCredit Bank

Më datë 31 maj 2013, pranë Drejtorisë Qendrore të ProCredit Bank u organizuan takime të hapura, ku çdo kandidat i interesuar për mundësi punësimi pranë bankës mund të merrte më shumë informacion mbi programin "Bankierët e Rinj", i cili është mundësia e vetme e hyrjes në ProCredit Bank.



RAIFFEISEN BANK

Raiffeisen Bank mbështet aksionet për pastrimin e bregdetit të Spillesë në Kavajë

Raiffeisen Bank, për të pestin vit radhazi, ka mbështetur nismën e Forumit të Mendimit të Lirë në aksionet e organizuara për pastrimin e bregdetit. Këtë vit, në datën 1 qershor, stafi i Raiffeisen Bank në Durrës, Kavajë dhe Divjakë iu bashkua 150 vullnetarëve, të cilët morën pjesë në aksionin e Korpusit të Vullnetarëve për pastrimin e plazhit të Spillesë në Kavajë.



TIRANA BANK



Memoriali Ndërkombëtar i Boksit, Vllaznia 2013

Për të dytën herë Tirana Bank mbështeti organizimin e veprimtarisë: “Memoriali Ndërkombëtar i Boksit, Vllaznia 2013” në qytetin e Shkodrës, me pjesëmarrjen e 110 boksierëve nga 11 vende të ndryshme të botës. Kjo veprimtari organizohet në kujtim dhe nderim të figurave të sportit që nuk jetojnë më.

Panairi i punës në Universitetin Evropian të Tiranës dhe Universitetin e New York-ut në Tiranë

Në datat 16 dhe 23 maj u zhvillua panairi i punës respektivisht në Universitetin Evropian të Tiranës dhe në Universitetin e New York-ut në Tiranë (UNYT). Tirana Bank si pjesëmarrëse aktive në panairin e punës të organizuara nga universitete të ndryshme, ofron këshilla punësimi dhe rekruton studentët më të mirë. Studentët e vitit të tretë dhe në përfundim të studimeve master në këto universitete patën mundësinë të dorëzonin CV-të e tyre, si edhe të intervistoheshin nga stafi i burimeve njerëzore të Tirana Bank. Tirana Bank i uron suksese të gjithë studentëve pjesëmarrës në këto evente.

BRUNILDA HALILI

Drejtoreshë e Degës Tirana Bank,
Librazhd



VENETO BANKA



Veneto Banka sërish në Himarë - në vijim të bashkëpunimit dhe mbështetjes që i ka dhënë Bashkisë së Himarës, Veneto Banka ishte një nga sponsorët e organizimit të çeljes së sezonit turistik. Veneto Bank është edhe sponsor zyrtar i ekipit të volejbollit për të reja “Himara Volley”.

Veneto Banka promovon sportin e volejbollit - Veneto Banka ishte i vetmi sponsor i finales së madhe të playoff-it në volejboll për femra, mes ekipeve “Marin Barleti Volley” dhe “Tirana”, ku ekipi i Tiranës u kurorëzua si kampion kombëtar.

Veneto Banka në Panairin e Punës - Veneto Banka morri pjesë për të tretin vit rradhazi në Panairin e Punës, i cili u organizua nga Ministria e Punës dhe Çështjeve sociale në Pallatin e Kongreseve. Zgjerimi i rrjetit të Veneto Banka me degë të reja në të gjithë vendin, kërkon më shumë burime njerëzore.

Megjithëse ngarkesa në punë është e madhe, Brunilda mundohet të organizojë ditën në mënyrë që të gjejë kohë edhe për pasionin e saj, vallet popullore. Brunilda është përgjegjëse e grupit të Librazhdit, si dhe vajza e koreografit dhe mjeshtrit Sadi Halili, emrin e të cilit mban edhe grupi. “Ansambli Sadi Halili” është krijuar në vitin 1969 dhe ka marrë pjesë në shumë aktivitete konkurruese kombëtare, ndërkombëtare si edhe në trevat shqiptare dhe gjithmonë është vlerësuar me kupa festivali, me çmime të para, të dyta ose të treta. Ansambli numëron 70 valltarë, nga moshë 5 deri në 25 vjeçare.

Në datat 11 deri në 13 maj 2013 u zhvillua për të shtatin vit radhazi në qytetin e Vlorës: “Aulona Fest Folk”, festivali ballkanik, ku marrin pjesë ansamble nga vende të ndryshme, si: Bullgaria, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia etj. Këtë vit ishte ansambli i grupit të Librazhdit, që përfaqësoi qytetin në këtë aktivitet, i cili u vlerësua me çmimin për “paraqitjen më të mirë”.

Brunilda është marrë me aktivitete kulturore që në moshën 6 vjeçare, si valltare dhe prej vitit 1997 e në vazhdim ka qenë ndihmës koreografe e babait të saj dhe menaxhere e ansamblit. Ajo ka përfaqësuar Shqipërinë me ansamblin në shumë shtete dhe festivale, si në: Itali, Greqi, Gjermani, Francë, Turqi, Austri, Bullgari, Maqedoni, Kosovë, Mal i Zi, Zvicër, Poloni etj.

LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE - HERCEGOVINË

**FMN jep 39 milion euro hua për Bosnjë-Hercegovinën**

Balkans.com - 07.05.2013

Fondi Monetar Ndërkombëtar do t'i akordojë Bosnjë-Hercegovinës një hua prej 39 milion euro, si pjesë e një programi, që do të shërbejë për të ndihmuar ekonominë vendase dhe për të stabilizuar financat publike. FMN i ka bërë thirrje Bosnjë-Hercegovinës të tregohet e shtrënguar me shpenzimet këtë vit, për të siguruar konsolidim fiskal.

Sektori bankar në Bosnjë-Hercegovinë ruan stabilitetin

Balkans.com - 07.06.2013

Sektori bankar në Bosnjë - Hercegovinë ka ruajtur stabilitetin e tij gjatë tremujorit të parë të vitit, pavarësisht kushteve të vështira dhe ndikimeve negative. Huat në fund të tremujorit të parë arritën në 10.7 miliard KM dhe aktivet u rritën 1.1 për qind; kapitali u rrit me 1.8 %. Duket qartë një përmirësim i përfitueshmërisë në krahasim me vitin e kaluar, që vjen si rezultat i qasjes së një metodologjie të re. (zbatim i MRS 37-39).

BULLGARIA

**Rriten huat e këqija dhe të ristrukturuara të sistemit bankar bullgar**

Balkans.com - 31.05.2013

Në muajin prill, u vu re një rritje e huave të këqija dhe të ristrukturuara në sistemin bankar bullgar. Pjesa e këtyre huave nga totali i huave për biznes dhe familje (përfshirë overdraftet), është rritur nga 0.7 për qind në 23.3 për qind. Kjo rritje e ardhur pas një periudhe rënie, vjen si pasojë kryesisht e detyrimeve problematike të shoqërive (në sektorin jo-financiar), që u rritën me 25.5 për qind.

Bullgaria do të vijojë me kufizimet e fondeve për shoqëritë shtetërore nga bankat tregtare

Focus - 13.06.2013

Qeveria bullgare e Kryeministrit Plamen Oresharski do të mbajë të paktën deri në fund të periudhës tranzitore 6-mujore, kufizimet e prezantuara nga kabineti i përkohshëm, për financimin e shoqërive shtetërore në bankat tregtare. Sipas rregullave të reja ekspozimi neto i një shoqërie nuk kalon 25 për qind e kapitalit të disponueshëm. Disa nga bankat më të preferuara të



shoqërive shtetërore janë: Corporate Commercial Bank dhe Central Cooperative Bank. Situata e sektorit bankar dhe huat e këqija kanë qenë çështje për diskutim në Parlamentin bullgar.

KOSOVA

**Caktimi i kodit të veçantë shtetëror për Republikën e Kosovës nga ana e SWIFT-it**

BQK - 07.05.2013

Shoqata për Telekomunikim Financiar Ndërbankar Mbarëbotëror (SWIFT) ka caktuar një kod të veçantë shtetëror identifikues për institucionet financiare të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, mbi bazën e këtij kodit të veçantë shtetëror, SWIFT-i ka nisur procesin e krijimit të kodit të identifikimit ndërkombëtar - BIC të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) dhe të lidhjes së saj në sistemin e SWIFT-it. Vendimi i SWIFT-it për përdorimin e një kodit të veçantë shtetëror për Republikën e Kosovës u mor si përgjigje në kërkesën përkatëse të BQK-së, e cila u mbështet nga bankat qendrore të vendeve të grupit G-10, si dhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Nënshkruhet memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës

BQK-12.06.2013

Në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet të

BQK-së dhe Njësisë për Inteligjencë Financiare. Qëllimi i këtij Memorandumi është që të vendosë natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet NJIF-K dhe BQK-së dhe po ashtu sqaron pritjet dhe synimet e tyre. Ndërkohë, ky memorandum mundëson lehtësira për shkëmbimin e informacionit ndërmjet dy institucioneve, shtohet niveli i bashkëpunimit dhe koordinimit, përmirësohet niveli i sigurisë, si dhe përshpejtohet procesi i shkëmbimit të informacionit në mes të palëve, lidhur me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

KROACIA



S&P: Bankat sllovene, bullgare dhe kroate ndër më të dobëtat në rajon

Balkans.com - 05.04.2013

Bankat e Europës Qendrore dhe Lindore janë përballur me një vit të vështirë, ku ato në Hungari, Slloveni, Bullgari dhe Kroaci janë ndër më të dobëtat, sipas një raporti të sektorit publikuar nga agjencia e klasifikimit 'Standard and Poor'. "Bankat e rajonit do të vazhdojnë të përballen me nivelet e larta të huave të këqija dhe të humbura, kërkesë të ulët për hua dhe marzhe të ulëta fitimi", shkruan S&P në raportin e saj: "Perspektivat e Bankingut në Europën Qendrore dhe Lindore 2013: Një tjetër vit i vështirë në një klimë të dobët ekonomike".

Kroacia mban monedhën e saj

NZ week - 10.05.2013

Sipas zëvendëskryeminstres së parë të Kroacisë, zj. Vesna Pusic, vendi do të mbajë monedhën e tij kombëtare dhe nuk do të vijojë me futjen e euro-s. Sipas zj. Pusic, që është gjithashtu dhe ministre e Punëve të Jashtme dhe Europiane, është më mirë që vendi të ecë ngadalë dhe të përgatitet mirë. Kroacia, e cila i bashkohet BE-së më 1 korrik 2013, ka vuajtur disa vite recesioni, duke përjetuar rënie të biznesit dhe rritje të papunësinë, që arrin në mbi 20 për qind.

GREQIA



Greqia rikapitalizon katër banka të mëdha

City A.M. - 22.05.2013

Fondi i shpëtimit të bankave greke do të synojë të shesë Hellenic Postbank dhe Proton nga mesi i muajit korrik 2013, ndërkohë që, sipas një përmbledhjeje inspektimi të huadhënësve të huaj në vend, bankat e mëdha vazhdojnë të absorbojnë huadhënësit e vegjël, si pjesë e planeve për të rigjallëruar këtë sektor të goditur keq. Greqia po rikapitalizon katër bankat e saj të mëdha, duke


likuiduar të tjerat që konsiderohen të pamundura për të përmirësuar kapacitetet e sektorit në drejtim të financimit të ekonomisë, pas 6 vitesh recesioni të thellë.

BEI i ofron për herë të parë Greqisë lehtësi në biznes

Balkans.com, Ekathimerini - 13.06.2013

Banka Europiane e Investimeve (BEI) i akordoi mbi 500 milion Euro Greqisë për të financuar biznesin e SME-ve. Marrëveshja e financimit u nënshkrua nga tre banka greke: National Bank of Greece S.A., Piraeus Bank S.A. dhe Eurobank Egasias S.A., si dhe tre banka të huaja: Corporate and Investment Banking, HSBC Greece dhe Commerzbank AG.

MALI I ZI



Sektori bankar në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore më mirë se homologët e Europës Perëndimore

Balkans.com - 14.05.2013

Në drejtim të rritjes dhe fitimit, sektori bankar në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore vazhdon të ketë një performancë më të mirë se homologët e Europës Perëndimore. Krijta vjetore totale e portofolit të kredive në 2012 në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore arriti 14.8 % në euro. Një tjetër rritje ishte ajo e kredisë reale të akumuluar për 2010-2012 në 21.8%; në Eurozonë kreditë reale patën një trend negativ duke iu referuar të njëjtës periudhë kohore. Bankat në këto vende vazhdojnë të përfitojnë nga mundësitë e rritjes, të cilat janë më të larta se në Europën Perëndimore.

Mali i Zi angazhon bankat e huaja lidhur me emetimin e obligacioneve në tregun ndërkombëtar

Reuters - 29.05.2013

Republika e Malit të Zi, e vlerësuar me notën Ba3/BB-, sipas dy burimeve të pavarura, ka angazhuar Citigroup, Deutsche Bank dhe Erste, lidhur me emetimin e obligacioneve në tregun ndërkombëtar. Një nga dy burimet pohoi se Qeveria pritet të realizojë emetimin e ri në mes të muajit qershor 2013.

MAQEDONIA



Maqedonia u kërkon bizneseve të aplikojnë për hua me normë interesi të subvencionuar

Balkans.com - 20.05.2013

Ministri i Ekonomisë së Maqedonisë, z. Valon Saracini, u kërkoj bizneseve të aplikojnë për hua me normë interesi të subvencionuar nga MBPR. Sipas të dhënave më të fundit, shoqëritë kanë përdorur 61 milion euro nga linja e huas prej 100 milion euro e akorduar nga Banka Europiane e Investimeve për 200 projekte. "Përdorimi i 100 milion

eurove do të hapë 1.300 vende të reja pune. Kjo tregon se normat e interesit të linjës së huas, burimi më i lirë i financimit në këtë rast, është interesi prej 5.5 për qind, deklaroi ministri". Ai u kërkoi bizneseve të përfitojnë nga ky avantazh që aksionarët kanë nga procedurat e huamarrjes, të cilat zgjasin maksimumi 45-60 ditë.

KDB Bank planifikon hapjen e degëve, në: Rumani, Serbi, Kroaci, Greqi dhe Maqedoni

BBJ - 29.05.2013

Banka shtetërore Korea Development Bank ka riemërtuar Hungary KDB Bank Europa në Hungari dhe synon ta përdorë atë si bazë për zgjerimin e saj në rajon, citon agjencia e lajmeve MTI. KDB Bank synon që KDB Bank Europa, të hapë degë të saj, në: Sllovakia, Republikën Çeke, Austri, Rumani, Moldavi, Serbi, Ukrainë, Rusi, Maqedoni dhe Greqi, duke filluar nga viti 2018.

RUMANIA



Intesa Sanpaolo Bank Romania prezanton shërbimin U Turn të rimbursimit tatimor për shoqëritë aksionare

Business Review - 24.05.2013

Intesa Sanpaolo Bank Romania, ka realizuar një marrëveshje vendore me U Turn Tax Refund (UTTR), me qëllim lehtësimin e rimbursimit të TVSH-së. Disa lloje shpenzimesh mund të rimbursohen nga 40 vende në mbarë botën, nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian, Norvegjia, Zvicra, Kanadaja, Austria dhe Japonia, të tilla si: hotele dhe forma të tjera akomodimi, ushqim në restorante, dhënia me qira dhe mirëmbajtja e makinave, taksitë dhe transport publik, karburantet, ekspozitat dhe panairët, kurset e trajnimit dhe seminarët etj.

Rënia e normave të interesit bankar në Rumani

Balkans.com - 30.05.2013

Normat e interesit bankare në Rumani po tregojnë një prirje rënëse, ndërkohë që procesi i huadhënies është thuajse i bllokuar. Sipas bankierëve, rifillimi i kreditimit të individëve mund të bëhet vetëm pas disa tremujorëve rritje të qëndrueshme, ndjekur nga një përfshirje më të madhe të bankave në shoqëritë e kreditimit.

SERBIA



Banka Qendrore e Serbisë sheh mundësinë e uljes së kostove të huamarrjes

Bloomberg - 14.05.2013

Sipas një sondazhi me ekonomistët, për herë të parë që nga janari 2012 Banka Qendrore e Serbisë, po sheh


mundësinë e uljes së kostove të huamarrjes, për të nxitur rritjen ekonomike. Narodna Banka Srbije do të ulë normën bazë njëjavore të marrëveshjeve të riblerjes nga një çerek pike në 15.50 për qind, sipas 11 nga 23 ekonomistëve të përfshirë në sondazhin e Bloomberg-ut. Politika monetare serbe është e vendosur të ndjekë pjesën tjetër të Europës Lindore, ku kostot e huamarrjes janë në rënie, për të nxitur rritjen ekonomike.

Banka Qendrore e Serbisë adopton ndryshime dhe plotësime në legjislacionin për mbikëqyrjen bankare

Central Bank of Serbia; Balkans.com - 20.05.2013

Banka Qendrore e Serbisë adopton ndryshime dhe plotësime në legjislacionin për mbikëqyrjen bankare lidhur me rregulloren për dhënien e lejes paraprake të themelimit të bankës, licencën e funksionimit të bankës dhe aprovimet nga Banka Kombëtare e Serbisë, si dhe dispozitat lidhur me vendosjen e kriterëve për përcaktimin e një banke cilësore. Për më tepër, vendimi për menaxhimin e rrezikut u ndryshua për të lejuar bankat të transferojnë arkëtime nga subjekte ligjore dhe sipërmarrësit (të vonuara ose jo) te bankat e tjera.

TURQIA



Turqia hap dritën e gjelbër për dhënien e licencave të reja bankare

Trend.az - 13.05.2013

Pas krizës së sistemit bankar të vitit 2001, Turqia ka hapur dritën e gjelbër për dhënien e licencave të reja për bankat, pa përjashtuar bankat islamike. Kryeministri turk, Ali Babaxhan, gjatë mbledhjes vjetore të Unionit të Bankave me Investime Pjesëmarrëse Turke, tha se formati i dy bankave të tilla do të jetë i qartë pas disa muajsh. Bankat shtetërore, si: Ziraat Bank and Halkbank, janë bankat që do krijojnë këto dy banka.

Rriten pagesat online me karta gjatë vitit 2012

Balkans.com - 05.06.2013

"Raporti për metodat e pagesave online në Europë 2013 - gjashtëmujori i parë për 2013", i përgatitur nga shoqëria e kërkimeve në treg yStats.com, ofron informacion lidhur me lëvizjen drejt transaksioneve të blerjeve online dhe nëpërmjet telefonit. Sipas raportit për Europën Qendrore, ndërgjegjësimi i metodave të pagesave ndërmjet telefonit ishte relativisht i lartë në vitin 2012. Europa Perëndimore, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca janë në rrugën e adoptimit të metodave alternative të pagesës. Vendet e Europës Lindore gjithashtu po shkojnë drejt pagesave online dhe nëpërmjet telefonave celularë. Në Turqi pagesat online me karta janë rritur me 33 për qind gjatë vitit 2012. Pagesat nëpërmjet telefonave celularë gjithashtu janë në rritje në Turqi, duke arritur një numër dy shifror në miliona euro.

E-COMMERCE – NJË REALITET TASHMË I PREKSHËM NË SHQIPËRI



nga Zj. Marsela KUSHTA
Përgjegjëse e Sektorit të Operacioneve
Departamenti i Kartave,
CREDINS BANK

Credins Bank ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të qenë në pararojë të arritjeve të sistemit dhe industrisë bankare në Shqipëri e jo vetëm, duke shënuar rritje të ndjeshme në të gjitha fushat dhe treguesit. Credins Bank ka shtuar në vijim gamën e produkteve dhe shërbimeve në fushën e pagesave elektronike, duke rritur kështu praninë në tregun bankar shqiptar. Nisur nga komoditeti, siguria, shpejtësia dhe eficientia që ofrojnë format e reja të pagesave elektronike kundrejt *cash-it*, çeqeve etj., Credins Bank ka synuar vazhdimisht futjen e teknologjive të reja në këtë fushë. Kështu, në mbështetje të biznesit dhe për t'ju përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje të klientëve, Credins Bank vendosi të prezantojë në tregun bankar shërbimin e ri *e-Commerce*, duke qenë ndër të parat banka në Shqipëri që kanë ndërmarrë këtë nismë. VISA mbështetur dhe në treguesit e lartë të bankës, si lëshues kartash dhe në rritjen e pozicionit të bankës në treg, i akordoi Credins Bank licencën për *e-Commerce* dhe *POS Merchant Acquiring*, shërbime këto që priten të përmirësojnë të gjithë treguesit, jo vetëm si lëshues, por dhe si pranues transaksionesh me karta. Klientët e bankës do të përfitojnë kështu nga përparësitë e njëres prej alternativave më bashkëkohore në sistemin elek-

tronik të pagesave.

Transaksionet e kryera me kartë në *e-Commerce* përmbajnë informacione të ndjeshme, që në dallim nga ato ballë për ballë, mbartin rrezik më të lartë, si për biznesin ashtu dhe për klientin kartëmbajtës. Klientët e bankës, që në rastin konkret janë tregtarët që ofrojnë produktet dhe shërbimet e tyre *online*, por dhe ata që blejnë *online* duke përdorur kartat e tyre VISA, me të drejtë pretendojnë komoditetin, lehtësinë, shpejtësinë që ofron shërbimi, pa cënuar sigurinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Kështu, për t'i dhënë klientëve sigurinë e nevojshme në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve *online*, VISA, si një sistem pagesash tepër i besuar në të gjithë botën, i ka shtuar vlerën *e-Commerce* nëpërmjet teknologjisë VbV (*Verified by VISA*), që ofron një shërbim të sigurt dhe mbrojtje nga përdorimi i paautorizuar i të dhënave personale të kartëmbajtësve. Për klientët e Credins Bank (tregtarët që kërkojnë të shesin *online*), aplikimi i teknologjisë VbV është i detyruar, pra banka nuk pranon ofrimin e shërbimit *e-Commerce* për klientët që nuk janë përfshirë në VbV, si kusht kryesor për një shërbim të sigurt dhe cilësor, nëpërmjet të cilit klientët kartëmbajtës blejnë *online*, me besimin që siguria e shërbimit përbën një nga prioritetet kryesore të tregtarit. Nëpërmjet saj bëhet i mundur identifikimi i kartëmbajtësit që kryen pagesën në faqen e internetit të biznesit dhe jepet siguri e plotë për blerjet *online*. Transaksionet e kryera *online*, nëpërmjet VbV, autorizohen

E-Commerce është shërbimi më i fundit i ofruar nga Credins Bank, nëpërmjet të cilit klientëve ju mundësohet shitja online dhe pranimi i pagesave me kartat VISA, lëshuar brenda dhe jashtë vendit, të aksesueshme nëpërmjet internetit.

vetëm pasi të bëhet autentifikimi i tyre përmes vendosjes së një fjalëkalimi.

Vendimarrja për të ofruar shërbimin *e-Commerce* kalon në një proces të kujdesshëm analize, në të cilën përfshihen specialistë të ndryshëm, duke ndjekur procedura rigorozë dhe kërkesa specifike për këtë lloj shërbimi. Banka ka gjithashtu standarde të caktuara dhe ushtron kontrolle, për të verifikuar zbatimin e tyre nga klienti (tregtari që shet *online*). Faqja nëpërmjet së cilës realizohen shitjet e produkteve dhe shërbimeve duhet të jetë e lehtë në përdorim dhe të pasqyrojë me transparencë kushtet me të cilat ofrohet produkti ose shërbimi. Mallrat ose shërbimet e ofruara duhet të përshkruhen në mënyrë të detajuar, të pasqyrohet qartë infor-

Aktualisht ka qindra faqe që mbështesin shitjen online të një produkti, ose shërbimi të caktuar dhe qindra (në mos mijëra) të tjera parashikohen të hyjnë në biznesin e tregtisë online. Shifrat dhe statistikat flasin për një rritje dyshifrore çdo vit.

macioni mbi politikat e kthimit dhe rimbursimit të mallrave dhe shërbimeve, afatet kohore dhe kufizimet, çmimi përfundimtar i produktit ose shërbimit të ofruar (përfshirë transportin, taksat etj.), emri i plotë e i saktë i tregtarit, numrat e kontaktit për shërbimin dhe kujdesin ndaj klientit etj. *Amazon* është ndoshta shembulli më i mirë se si një faqe mund të ofrojë një shërbim aq cilësor dhe profesional, duke ju përshtatur preferencave individuale të klientëve.

Rol kyç në suksesin e biznesit që ofron shërbimin *e-Commerce*, luan *design*-i i faqes, por mbi të gjitha funksionaliteti dhe ecuria e saj. Është e provuar se çdo vonesë në hapjen e faqes ose çdo vështirësi në përdorimin e saj, përkthehet në një koeficient "braktisje" të faqes nga përdoruesi, që sigurisht dëmton biznesin dhe imazhin e tregtarit. Në ndërtimin e faqes duhet patur parasysh që ofrohet një produkt ose shërbim virtual, që është më i vështirë të perceptohet nga klienti, sesa në rastin kur blerja bëhet në një dyqan fizik. Kjo shpesh e bën të domosdoshme paraqitjen vizuale, sa me të qartë e të plotë të produktit ose shërbimit, përshkrimin në detaje të tij, kategorizimin sipas karakteristikave, për të rritur kështu besimin e klientit gjatë blerjeve *online*.

Shitja *online* është një zgjidhje e përshtatshme jo vetëm për shoqëritë e mëdha me marka prestigjioze, por edhe për biznese më të vogla, të cilat nëpërmjet postës bëjnë dërgimin e produktit/shërbimit, deri te blerësi më i largët. Çdo biznes i regjistruar dhe i licencuar, që kërkon të tregtojë (shesë) produktet ose shërbimet e veta *online*, përbën një klient potencial *e-Commerce*. Tregtari që zotëron një faqe interneti sipas standardeve të përcaktuara për të ofruar këtë shërbim, pranon pagesat *online* me karta VISA, të cilat kalojnë në llogarinë e tregtarit pranë Credins Bank; mjafton që tregtari të plotësojë kushtet e paracaktuara (në përputhje me politikat dhe procedurat e VISA-s dhe ato të Credins Bank), të ketë një marrëdhënie biznesi me bankën, si dhe të aplikojë për shërbimin. Biznesit i instalohet një menu e dedikuar në faqen e internetit nga ku klientët mund të kryejnë pagesën, pasi kanë zgjedhur produktin/shërbimin e dëshiruar. Instalimi i saj realizohet në bashkëpunim dhe me tregtarin, ku bizneseve të interesuara, që janë klientë të bankës, ju ofrohet asistencë e nevojshme teknike. Në faqet e internetit

të bizneseve klientë të Credins Bank e që kanë një llogari bankare biznesi, mund të kryhen blerje nga klientë me karta VISA të lëshuara në të gjithë botën. Çdo biznes mund të informohet për pagesat e kryera në llogarinë e tij në Credins Bank, nëpërmjet një raporti të transaksioneve mujore, apo nëpërmjet shërbimit *e-banking*.

Aktualisht ka qindra faqe që mbështesin shitjen *online* të një produkti, ose shërbime të caktuar dhe qindra (në mos mijëra) të tjera parashikohen të hyjnë në biznesin e tregtisë *online*.

Shifrat dhe statistikat flasin për një rritje dyshifrore çdo vit. Shërbimi ofrohet nëpërmjet internetit, duke patur kështu kërkesa minimale për investime fillestare dhe infrastrukturë, duke e bërë "tregtinë" *online* një alternativë tërheqëse për shumë biznese. Kjo është dhe arsyeja që numri i bizneseve që shesin *online* dhe numri i klientëve që blejnë *online* rritet çdo ditë. *E-Commerce* përbën sot një industri miliarda dollarësh, me një perspektivë dhe prirje gjithnjë në rritje.

ÇFARË ËSHTË E-COMMERCE?

E-Commerce është pranimi i pagesave në tregtinë elektronike, që u mundëson bizneseve shkëmbimin nëpërmjet internetit me konsumatorët, të produkteve dhe shërbimeve. Bizneset shesin produkte dhe shërbime nëpërmjet faqeve të tyre të internetit, duke pranuar pagesat me karta të klientëve. Transaksionet *e-Commerce* realizohen *online*, duke përdorur një pajisje aksesimi nga klientët kartëmbajtës (kompjuter ose terminal tjetër), në të cilin futen të dhënat e nevojshme, për të realizuar transaksionin. Klienti inicion transaksionin duke hedhur të dhënat e kartës që përdoret si mjet pagese, për produktin ose shërbimin e përfituar *online* nga faqja e tregtarit. Nëpërmjet *e-Commerce* bizneset mund të shesin më shumë, më me siguri, më shpejt, më mirë, më lirë, e pa kufizime në kohë e distancë.



PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE NGA INDIVIDËT DHE BIZNESET

Vështrim i përgjithshëm mbi dy studime të Bankës së Shqipërisë¹



Z. Kliti CECA

Përgjegjës i Sektorit të Kërkimeve
Ekonomike, Departamenti i
Kërkimeve, Banka e Shqipërisë



Zj. Valentina SEMI

Përgjegjëse e Sektorit të Politikave
dhe Mbikëqyrjes së Sistemeve të
Pagesave, Departamenti i Sistemit
të Pagesave, Banka e Shqipërisë



Z. Alban PLLAHA

Specialist, Sektori i Kërkimeve
Metodologjike në të Dhëna Mikro,
Departamenti i Kërkimeve,
Banka e Shqipërisë

Nxjtja e funksionimit normal të Sistemeve të Pagesave përbën një nga objektivat e Bankës së Shqipërisë. Ndër të tjera, ruajtja dhe promovimi i sigurisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave përbën një parakusht thelbësor për zbatimin me efikasitet të politikës monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Në këtë kuadër, duke marrë parasysh dhe faktin se instrumentet e pagesave përbëjnë një pjesë integrale të sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar dhe vijon t'i kushtojë atyre vëmendje të veçantë. Për më tepër, bazuar në literaturën ndërkombëtare, është vënë re se përdorimi i instrumenteve elektronike të pagesave paraqet një korrelacion negativ me përdorimin e parasë fizike në ekonomi, gjë që vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejt në zbatimin e politikës monetare dhe stabilitetit financiar. Banka e Shqipërisë, bazuar në vëllimet relativisht të ulëta të pagesave me instrumente elektronike, përtej masave lidhur me përmirësimet në kuadrin rregullativ e ligjor,

si dhe zhvillimeve infrastrukturore, po i kushton vëmendje të veçantë dhe pjesës studimore të instrumenteve të pagesave, gjë që vlerësohet të ndihmojë ndjeshëm procesin e vendimmarrjes dhe reformave të parashikuar për fushën e sistemit të pagesave.

Në kuadrin e vlerësimit të opinioneve të cilat kanë përdoruesit e instrumenteve të pagesave, u organizuan dy anketime, në periudhën shkurtmars 2012, ku u vlerësuan çështje të ndryshme lidhur me këto instrumente. Anketimet u mundësuan nga Banka e Shqipërisë, të konceptuara dhe të zhvilluara si projekte shkencore nga Departamenti i Kërkimeve, me mbështetjen e Departamentit të Sistemeve të Pagesave dhe Departamenti i Statistikës të Bankës së Shqipërisë, i realizuar në terren nga INSTAT.

Anketimi i parë u realizua me popullatën e individëve, që kanë një llogari bankare. Zgjedhja, me rreth 200 individë, u realizua në zonën Tiranë - Durrës, si zonë me denduri popullore më të madhe. Anketimi synoi

identifikimin e karakteristikave të individëve, që ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumenteve të pagesave nga ata.

Anketimi i dytë u realizua me popullatën e bizneseve. Në përzgjedhjen e tyre si kusht bazë, u mor përzgjedhja e 200 bizneseve, që ofrojnë pagesa nëpërmjet aparateve POS dhe përzgjedhja e 200 bizneseve të tjera, që nuk ofrojnë pagesa të tilla. Në këtë mënyrë u krijua mundësia për të bërë vlerësime të nevojshme për secilin prej grupeve, e nga ana tjetër, u krijua mundësia për të bërë analiza krahasuese ndërmjet grupeve. Ky anketim synoi gjithashtu, identifikimin e karakteristikave të bizneseve, të cilat ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumenteve të pagesave prej tyre.

Theksojmë se të dy studimet janë të bazuara mbi anketime publike. Ato

Thellimi i edukimit financiar për rritjen e kulturës së kësaj fushe dhe prirja e kthimit të saj në një kulturë të përgjithshme është një gjetje që mbështet nismën disaveçare të Bankës së Shqipërisë për thellimin më tej të edukimit financiar të publikut.

¹ Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe ato nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe politikën e Bankës së Shqipërisë.



WHAT INSPIRES YOU TODAY?

Disa njerëz gjithmonë janë duke kërkuar frymëzim dhe ë gjejnë atë rreth tyre. Për këta njerëz INTESA SANPAOLO BANK ka krijuar Inspire (Frymëzimin), kartën e re të debitit që do t'ju shoqëroj juve kudo ku do t'ju çojë frymëzimi juaj. Kartë Inspire është me ju kudo që dëshironi dhe kudo ku ndodhëni, me seriozitetin e një prej grupeve kryesore ndërkombetare bankare: Intesa Sanpaolo. Përdoreni për blerjet tuaja në të gjithë botën dhe për tërheqje parash të sigurta dhe pa komision në dymbëdhjetë bankat që janë pjesë e Grupit.

Go beyond your borders. Go Inspire.



Kartë e Debitit Inspire është e disponueshme vetëm me logarinë rrjedhëse

Tërhiqni para pa komision në të gjitha ATM e bankave të Grupit Intesa Sanpaolo

- | | | | |
|----------|---------|--------|---------|
| Shqipëri | Egjypt | Rumani | Slovaki |
| Bosnje | Hungari | Rusi | Sloveni |
| Kroaci | Itali | Serbi | Ukraine |

INTESA SANPAOLO BANK

Drejt të ardhmes me ju.

pasqyrojnë vlerësime të individëve dhe të subjekteve të anketuara për pyetjet e shtruara.

Informacioni i plotë mbi studimet

Analiza e anketimeve është publikuar nga Banka e Shqipërisë në periodikun e vet shkencor “Material shkencor” dhe aktualisht gjenden në kopje të printuar si dhe në kopje elektronike në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë¹.

Gjetjet kryesore nga anketimet

Disa nga gjetjet kryesore të anketimit me individët janë dhënë më poshtë:

Thellimi i edukimit financiar për rritjen kulturës së kësaj fushe dhe prirja e kthimit të saj në një kulturë të përgjithshme. Në disa prej çështjeve të këtij studimi shprehet në mënyrë të dukshme që thellimi i edukimit financiar lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e llogarive bankare dhe in-

strumenteve të pagesave. Kjo gjetje është dhe mbështetje për nismën disaveçare të Bankës së Shqipërisë për thelimin më tej të edukimit financiar të publikut.

Monitorimi i kulturës financiare të publikut në tërësi. Monitorimi i kësaj kulture nëpërmjet metodologjive të ndryshme, ku përfshihet dhe anketimi, do të mund të përcaktonte në mënyrë më të fokusuar mënyrën dhe çështjet konkrete të cilat do të duhej synuar edukimi i publikut.

Monitorimi më i thelluar i komisioneve dhe i shpërndarjes së tyre ndër instrumentet bankare. Një fakt i evidentuar gjatë studimit është dhe mosnjohja relative e të anketuarve me komisionet që shoqërojnë instrumente të ndryshme të pagesave. Kështu, vlerësohet se nisma e ndërmarrë nga ana e Bankës së Shqipërisë për publikimin e përqendruar të këtyre të dhënave, ka krijuar pa-

rakushtet për një informim më të mirë të publikut, në lidhje me këtë çështje, si dhe mundëson kryerjen e një përzgjedhje më të kujdesshme, nga ana e individëve dhe bizneseve, në lidhje me shërbimet e pagesave të ofruara nga sistemi bankar. Gjithashtu, kjo nismë vlerësohet se lehtëson dhe monitorimin e këtyre komisioneve, për nevoja studimore apo administrative.

Perceptimi më i thelluar i çështjeve mbi transparencën që lidhet me ofrimin dhe përdorimin e instrumenteve bankare. Lidhur me transparencën e ofruar nga sistemi i pagesave jo-cash, të anketuarit shprehin nevojën për më shumë transparencë në këto instrumente. Kjo mund të vijë për shkak dhe të mungesës së informimit. Gjithsesi vlerësohet që transparenca njëkohësisht rrit dhe informimin e publikut.

DISA NGA GJETJET KRYESORE TË ANKETIMIT ME BIZNESET:

Instrumentet e pagesave më të pranuar nga bizneset (përveç kartës së debitit apo kreditit, si kusht fillestar në realizimin e zgjedhjes së bizneseve), janë si vijon:

“Transferta e kreditit” me 40.57 %.	Pesha relativisht e lartë e përdorimit të këtij instrumenti është në përputhje me pritjet tona, pasi ky lloj instrumenti për vetë natyrën e tij mund të konsiderohet si një instrument më shumë i përdorur në transaksionet e bizneseve krahasuar me ato të individëve.
“Debitimi direkt” me 25.71 %.	Në lidhje me përdorimin relativisht të lartë të këtij instrumenti vlerësojmë se, përtej përqindjes së konsiderueshme që zënë kompanitë të cilat ofrojnë shërbime utilitare në vrotim, mund të diktohet edhe një familjarizim i kufizuar i bizneseve me këtë instrument, i cili konfirmohet gjithashtu edhe nga përgjigjet e bizneseve në lidhje me pranimin e këtij instrumenti për pagesa të cilat është e pamundur të kryhen nëpërmjet këtij instrumenti. Përdorimi, gjithsesi, disi i gjatë në kohë i “debitimit direkt” lë për të dyshuar në njohjen e saktë të tij, duke favorizuar kështu nevojën për thelimin e edukimit financiar.
Pranimi i “çekut” me 14.39 % “e-banking” me 13.21 %	Këto të dhëna konfirmojnë peshat e ulëta të cilat zënë këto lloj instrumentesh ndaj totalit të instrumenteve, sipas raportimeve të bankave pranë Bankës së Shqipërisë ³ .

- Bizneset që pranojnë pagesat nëpërmjet POS-ve, vlerësojnë se ndikimin më të madh në adoptimin e këtyre terminaleve për kryerjen e pagesave e kanë pasur elementët: “niveli i sigurisë” dhe “besueshmëria”. Ndërkohë “integrimi lehtësisht në sistemet e biznesit”, si dhe “lehtësia në përdorim” vlerësohen si dy tipare të tjera që kanë kontribuar ndjeshëm në adoptimin e këtyre terminaleve. “Kostot” duket se nuk kanë pasur shumë ndikim në adoptimin e POS për këtë kategori biznesesh.

- Bizneset që nuk pranojnë pagesa nëpërmjet POS-ve, vlerësojnë se do të adoptonin këto mënyra pagesash, nëse më shumë klientë do t’i kërkonin ato.

- Ndër tiparet e instrumenteve të pagesave, më të vlerësuara nga bizneset janë: “Kontakti me tregun: Rëndesa e numrit të blerësve që përdorin këto sisteme” dhe “Besimi: Sa besim keni në këto sisteme”, i vlerësuar gjithashtu si “shumë i rëndësishëm”.

- Tiparet e instrumenteve të pagesës, më pak të vlerësuara nga bizneset

janë: “Avantazh relativ i çmimit: Sasia e parave që kurseni duke përdorur këto terminale pagesash” dhe “Prezenca në treg: Sa keni dëgjuar për këto instrumente pagese”, gjithashtu e vlerësuar si “më pak e rëndësishme”.

- Komisionet të larta në përdorimin e POS. Vlerësohet që pretendime të tilla mund të ngrihen dhe nga biznese të vogla, për të cilat gjithsesi kostot e POS, në kushtet e kostove të ulëta të përdorimit të cash-it, mund të jenë domethënëse.

2 “Raport i anketimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesës – Bizneset, 2013, “Material diskutimi 01 (60) 2013”, K. Ceca, A. Pllaha, V. Semi. Shqip: http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_anketimit_mbi_perdorimin_e_instrumenteve_te_pageses_ndash_Bizneset_6581_1.php
“Raport i anketimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesës – Individët, 2013, “Material diskutimi 02 (61) 2013”, K. Ceca, A. Pllaha, V. Semi. Shqip: http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_i_anketimit_mbi_perdorimin_e_instrumenteve_te_pageses_ndash_Individet_6582_1.php
English: http://www.bankofalbania.org/web/Survey_report_on_the_use_of_payment_instruments_individuals_6582_2.php
3 Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2011, faqe 148.

AKTIVITETET E SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

AAB - PËR EDUKIMIN FINANCIAR

Broshura mbi kartat bankare

AAB, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, ka përgatitur një broshurë mbi kartat bankare dhe përdorimin e tyre, në vijim të angazhimit të ndërmarrë për edukimin financiar, e cila përmban informacion mbi kartat e kreditit, normat e interesit, standardet e transparencës, si dhe këshilla mbi përdorimin e duhur të kartave në internet. Broshurat po shpërndahen për studentët, degët e bankave, qendrat tregtare, etj.



Vizita të studentëve në mjediset e bankave

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet AAB dhe Universitetit Europian të Tiranës (UET), Zj. Endrita Xhaferaj, Sekretare e Përgjithshme e AAB dhe Zj. Najada Xhaxha (Tirana Bank), Kryetare e Komitetit të Sistemeve të Pagesave, drejtuan dy seminare për studentët, mbi sistemin bankar, si pjesë e programit të studimit Bachelor në Financë - Bankë. Në vijim të seminareve, AAB organizoi vizita në disa banka si pjesë e praktikës profesionale të studentëve, nga data 24 qershor deri më 1 korrik. Përfaqësues të bankave shpjeguan funksionimin dhe aktivitetet ditore të bankave në degë dhe zyra qendrore. Bankat të cilat mirëpritën studentët, ishin: Alpha Bank, BKT, Credins Bank, FIBank, Intesa San Paolo Bank, NBG Bank Albania dhe United Bank of Albania.

AAB - AKTIVITETE

Forumi i Tretë Kombëtar Shqiptar i Kartave, 17 maj 2013

AAB dhe Komiteti i saj për Luftën Kundër Mashtrimeve me Karta, organizuan për të tretin vit radhazi, Forumin Kombëtar Shqiptar të Kartave me temë "Drejt një të ardhme dinamike të biznesit", në Hotel Sheraton, Tiranë. Pjesëmarrës dhe referues në forum ishin përfaqësues të bankave tregtare në Shqipëri e Kosovë, të Bankës së Shqipërisë, të Visa dhe Master Card, të Policisë së Shtetit, të OPDAT, si dhe përfaqësues të shoqërive lokale e ndërkombëtare që ofrojnë shërbime teknologjike në fushën e pagesave elektronike, nga: INFIGO, EasyPay, Mellon, Printec, Asseco, Mpay, etj.. Në forumin e këtij viti u v theksi në analizën e tregut, si dhe zhvillimet më të fundit në industrinë e kartave dhe pagesave, nga këndvështrimi i mundësive të rritjes dhe zhvillimit të biznesit, si dhe rreziqeve që e shoqërojnë atë.



Forumi i Dytë Kombëtar Shqiptar i Sigurisë Bankare, 31 maj 2013

AAB dhe Komiteti i saj për Sigurinë Bankare, organizuan forumin kombëtar me temë: "Siguria në banka", i cili zhvilloi punimet e tij për të dytin vit radhazi, në Tirana International Hotel. Pjesëmarrës në aktivitet ishin përfaqësues të bankave tregtare në Shqipëri dhe Kosovë, të Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shoqërive të Ruajtjes së Sigurisë Fizike (SHRSF) dhe të shoqërive që ofrojnë shërbime dhe produkte në fushën e sigurisë bankare.

Tryezë diskutimi: “Mbi përmirësimin e raportimit të bankave, në kuadrin e luftës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, 05 maj 2013

AAB, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), organizoi në mjediset e “Sky Hotel”, një tryezë diskutimi mbi problematikat e hasura në raportimet e bankave në zbatim të ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në të morën pjesë përfaqësuesit e bankave, DPPPP-së dhe Bankës së Shqipërisë, të cilët diskutuan mbi problemet teknike specifike të hasura gjatë raportimeve, si dhe mbi mënyrat më të mira për t’i adresuar ato në të ardhmen.



Workshop mbi programin për energjinë e rinovueshme në Ballkan, 28 maj 2013

IFC në bashkëpunim me AAB, organizuan një seminar për përfaqësues të niveleve të larta drejtuese të bankave tregtare në vend, si pjesë e një programi më të zgjeruar mbi energjinë e rinovueshme në Ballkan (BREP). Në seminar u prezantua tregu potencial për investime në projektet e energjisë së rinovueshme në rajon, si dhe rreziqet më karakteristike që shoqërojnë atë. IFC prezantoi shërbimet e saj të konsulcencës ku përfshihen manuale, trajnime dhe asistencë, si dhe investimet për zhvillimin e sektorit të energjisë së rinovueshme.

AAB - TRAJNIME

Workshop për “Përmirësimin e lidhjeve elektronike ndërmjet përfituesve”, 05 prill 2013

AAB bashkëpunoi me Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Departamenteve të Teknologjisë së Informacionit të bankave në seminarin me temë: “Përmirësimi i lidhjeve elektronike ndërmjet përfituesve”. Ky aktivitet u organizua nën drejtimin e ekspertëve të Bashkimit Europian dhe trajtoi praktikat më të mira në bashkëpunimin me autoritet shqiptare dhe ndarjen e informacionit ndërmjet tyre, si dhe raportimin mbi kërkesat teknike për lidhjet elektronike.

Trajnim mbi “Mbi menaxhim e sigurisë së informacionit”, 14-16 maj 2013

AAB organizoi një kurs trajnimi tregitor mbi menaxhimin e sigurisë së informacionit, objektivi i të cilit ishte informimi i pjesëmarrësve mbi konceptet bazë të sigurisë, procesi cilësor dhe sasior i menaxhimit të rrezikut, etj. Kursi u ndoq nga 11 përfaqësues të 8 bankave anëtare.

Trajnim mbi “Aftësitë prezantuese në anglisht”, 15 prill 2013

AAB organizoi një kurs njëditor trajnimi mbi prezantimin efektiv në anglisht, për rritjen e aftësisë së komunikimit përballë audiencës. Ky kurs trajnimi interaktiv u drejtua nga Andy Zdan-Michajlowicz dhe u ndoq nga 5 përfaqësues të 2 bankave anëtare.



Trajnim mbi “Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme”, 22-23 maj 2013

AAB në bashkëpunim me Deloitte Albania organizuan një kurs dyditor mbi vlerësimin e pasurisë së paluajtshme, duke përfshirë të gjithë procesin dhe raportin e vlerësimit. Kursi u ndoq nga 15 punonjës të 6 bankave.



Takim-diskutimi mbi Bazel III, 13 qershor 2013

AAB në bashkëpunim me programin FSVC organizuan një takim-diskutimi mbi “Bazel III në lidhje me likuiditetet”, më 13 qershor 2013, në Hotel Tirana International. Referues ishin ekspertë të Bankës Qendrore daneze, të specializuar në kuadrin rregullator dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, sipas kërkesave të Bazel III.

